



AlbaniaFootball

2015, NR. 20

BOTIM ZYRTAR I FEDERATES SHQIPTARE TE FUTBOLLIT



Kundër Francës, më shumë se një miqësore

Intervista

Trajneri De Biassi:
Po përgatim edhe surpriza?



Zhvillimi i qarave

Statistikat e futbollit,
ndryshimi i sivjetëm



Vlerësimi

Arbitrat e linjës, e reja
e gjykitimit profesionist



Kundër Francës, më shumë se një miqësore	Faq 4
Trajneri: Po përgatisim edhe surpriza	Fq 8
Federata Shqiptare e Futbollit dhe Kryqi i Kuq Shqiptar	Fq 12
Fituesit e një edicioni të pazakontë	Fq 14
Statistikat e edicionit një risi	Fq 16
Hito Hitaj, një jetë me futbollin	Fq 20
NEWS	Fq 23
Arbitrat e linjës, e reja e gjykimit profesionist	Fq 27
Historia e “penalty kick”	Fq 31
Me Gjermaninë, një histori pa limite	Fq 35

Koha për të treguar... respekt

Tifozët, kjo pjesë e pazëvendësueshme e lojës, janë tashmë një realitet aq i gjallë dhe shpesh protagonist në futbollin e sotëm modern. “Konkurruese” me aq minuta sa kanë në dispozicion, tifozëritë i japin ndeshjeve të futbollit pamje magjepëse, të cilat askush veç tyre, nuk di ti dhurojë në atë mënyrë. Tashmë koreografitë që ata krijojnë, kanë hyrë në fondin më të rëndësishëm të ndeshjeve, duke i shndërruar ato në një magji dëfryese jo vetëm për të pranishmit në stadium por edhe për milionat që e ndjekin ndeshjen nëpërmjet ekranit të TV. Njësoj si me spektaklin në fushën e lojës, me driblimet, aksionet e shpejta apo golat e rrallë edhe shfaqja që japin tifozëritë të mbetet gjatë në mendje. Pa përmendur këtu, mbështetjen e pakufij, që ata i japin skuadrave të tyre. Por si kudo edhe këtu, nuk duhet kaluar masa...

Pak ditë më parë, Federata Shqiptare e Futbollit është njoftuar se është dënua nga ana e Komisionit të Disiplinës në UEFA, me 50.000 euro gjobë, për shkak të përdorimit të parullave raciste në ndeshjen e 29 marsit, Shqipëri – Armeni. Një lajm jo i mirë ky, për të gjithë. Si në aspektin moral, sepse krijohet precedentë të përdorimit të parrullave raciste dhe futemi në një hartë vendesh, të dalluara për këtë shfaqje të dënueshme. Ashtu edhe në aspektin material, ku shuma në fjalë nuk është e pavlerë, për një Federatë me të ardhura modeste, siç është Federata Shqiptare e Futbollit. Me një shumë të tillë, ishin bërë investime në disa prej impianteve të Shqipërisë për ti përmirësuar ato. Apo ishte ndërtuar një fushë e re në çdo qytet, ku një e tillë mungon. Dhe për më tepër, përse duhet ky penalitet? Që dikush, tre pesë apo dhjetë vetë, të plotësojnë fantazitë apo trillet e tyre, duke u fshehur pas turmës dhe pa menduar aspak për pasojat që ka një veprim i tillë.

Ekipi kombëtar, ne të gjithë e duam dhe kërkojmë mbështetjen tuaj të dëshur tifozë por për hir të saj, nuk ka pse të kalohet në ekstreme, që nuk i shërbejnë askujt. Madje përkundrazi, mund të na penalizojnë edhe më rëndë në të ardhmen.

Tifozë! Ju duam shumë, ashtu si edhe na doni e na mbështesni. Por duhet të heqim dorë nga disa shfaqje të dënueshme, që nuk i shërbejnë askujt. Dhe për më tepër, na dënojnë dhe penalizojnë financiarisht. Është koha, që të gjithë së bashku të bëjmë të pamundur për tu përmirësuar. Për të treguar vlerat dhe virtytet tona. Dhe besoj se kemi, jo pak. Është koha për të ndryshuar vetë dhe për të ndërhyrë që edhe miqtë e kolegët, të mos gabojnë. Është koha për të treguar anën tonë më të mirë.

Është koha për të treguar... respekt

Tritan Kokona
Editor i “Albania Football”



Të nderuar futbollistë, drejtues dhe sportdashës!

Të dashur miq!

Këto ditë, ne sapo mbyllëm edicionin futbollistik 2014-2015. Një punë gjigande e klubeve të futbollit dhe drejtuesve të tyre, e ekipeve dhe teknikëve të tyre, e gjyqtarëve, vëzhguesve dhe patjetër e zyrtarëve të FSHF. Një edicion i gjatë futbollistik i mbushur me ngjarje, emocione dhe vlera, i cili tashmë po arkivohet për ti takuar historisë. Dhe me që jemi tek ajo, mund ta konsiderojmë edhe një edicion historik, sa i takon dy elementëve të veçantë të cilët, janë konsideruar unikalë, si nga specialistët ashtu edhe nga media. Bëhet fjalë, për rivalitetin e pakrahasueshëm të një Kampionati shumë të fortë në Kategorinë Superiore por edhe në atë të Parën. Dhe të një cilësie mjaft të mirë të shumë prej ndeshjeve, të zhvilluara në Superiore. Për të parën, vështirë se dikush mund të jetë kundër fakteve kokëforta. Plot pesë skuadra ishin duke luftuar “kokë më kokë”, në pjesën më të madhe të sezonit, duke vënë kandidaturën për të qenë kampione të Shqipërisë.

Për të dytën, mjafton të përmendësh vetëm një fakt të thjeshtë: S'ka përse të rrëmosh shumë nëpër arkivat e këtij kampionati, që të gesh ndeshje të një niveli të lartë apo gola të bukur. Në çdo javë, do të ndeshësh me shumicë, nivel të mirë loje, spektakël dhe gola jashtëzakonisht të bukur. E gjithë kjo panoramë, bëhet edhe më interesante për sportdashësit, po të kemi parasysh shfaqjet e shkëlqyera që herë pas here, kanë dhënë tifozëritë e organizuara dhe transmetimin profesional të të gjitha ndeshjeve të Kategorisë Superiore, të cilat kanë qenë një tjetër risi për këtë edicion. Tani, gjithçka është mbyllur dhe gjithkush, ka mundësi që në qetësi, të bëjë analizën e punës së tij. Të atyre që arriti dhe objektivave të paplotësuara. I gjithë edicioni, duhet të jetë objekt i një analize të plotë dhe profesio-

nale, duke filluar nga organizatorët, Federata Shqiptare e Futbollit, për të vazhduar me klubet, ekipet dhe gjithë të tjerët. Vetëm duke gjykuar me objektivitet dhe duke parë me sy kritik arritjet e deritanishme, do të kemi mundësinë që të organizojmë edicionin e ardhshëm futbollistik, akoma më të mirë dhe kompetitiv. Duke u mbështetur tek arritjet e deritanishme dhe tek bashkëpunimi ynë i frytshëm, të punojmë dhe kërkojmë më shumë, që të garantojmë një tjetër edicion të suksesshëm, që do të nisë shumë shpejt me pjesëmarrjen e klubeve tonë në Kupat e Europës. Ky përfaqësim në vetvete, do të jetë një tjetër test i rëndësishëm për skuadrat tona, të cilat në mënyrë të veçantë parvjet, bënë një përfaqësim dinjitoz duke treguar vlerat e futbollit shqiptar në kontinent.

Të nderuar sportdashës!

Një tjetër, ngjarje e rëndësishme, gjatë kësaj periudhe të shkurtër, është edhe fillimi i punimeve në stadiumin “Loro Boriçi” të qytetit të Shkodrës. Një investim i rëndësishëm në infrastrukturën sportive të vendit, i cili është fryt i bashkëpunimit, mes Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Qeverisë Shqiptare. Tashmë pas “Elbasan Arena”, një tjetër impiant i rëndësishëm dhe modern, i shtohet sportit tonë të dashur, futbollit. Duke nxitur zbatuesit e projektit, për të kryer sa më mirë detyrën e tyre, ne urojmë që ky impiant të jetë edhe më cilësor, e më modern se i pari. Pastaj...

...Si të gjithë ata që kërkojnë më të mirën për ëndrrën e tyre, të shpresojmë në ndërtimin e një tjetri. Sepse futbolla shqiptar, meriton më tepër.

Armand DUKA
President i FSHF

Kundër Francës, më shumë se një miqësore

Një ndeshje si ajo kundër Francës, qoftë edhe pa shijen e marrjes së pikëve (Franca merr pjesë në Grupin I eliminator të Kampionatit European të vitit 2016 por ndeshjet që ajo luan nuk kanë vlerë pikësh për shkak se si vend organizator ajo është drejtëpërdrejtë e kualifikuar për në fazën finale), është një ndeshje luksi, e cila i shërben çdo skuadre për të testuar sa më mirë veten. I shërben për të matur forcat dhe për të kontrolluar nivelin e progresit që ka kryer gjatë një periudhe të caktuar. Kur luan me skuadra të mëdha të këtij niveli, menjëherë e kupton se nuk është vetëm kënaqësia për t'u përballur me elitën e futbollit botëror. Është një mundësi, për të njohur limitet e tua, forcën dhe karakterin e ekipit. Është një shans për të testuar rritjen e parametrave të lojës dhe ç' është më e rëndësishmja, për të arritur një shkallë pjekurie të domosdoshme për administrimin e lojës dhe marrjen e rezultatit...

Zgjedhjet e grupit dhe detaje të tjera

I ndërjegjshëm për rëndësinë e këtij takimi - test, mu në zemër të "udhëkryqit" të eliminatorëve (janë zhvilluar deri më tani gjysma e ndeshjeve), trajneri i

përfaqësueses shqiptare Giani De Biassi ka patur gjithsesi disa dilema në lidhje me këtë ndeshje. Të cilat vijnë nga tre arsye, që ai i shikon si shumë të rëndësishme. Së pari, mungesat për shkaqe dëmtimesh, ku ai është tepër i shqetësuar sidomos për ndërhyrjen që ka



patur mbrojtësi Mërgim Mavraj. Për të cilin ende nuk mund të thuhet saktësisht, se sa kohë do t'i duhet për tu rikuperuar, plotësisht. Pavarësisht këtij informacioni teknik që do të detajohet së shpejti, nga grupi i mjekëve që po e ndjekin nga afër futbollistin, mungesa hipotetike e Mërgim Mavrajt, sidomos për katër "finale" vendimtare të shtator-tetorit, mund të quhet shumë e rëndësishme. Së dyti, trajneri është shumë i qartë në faktin se, për shkak të impenjimeve të mëdha në kampionatet



Është një shans për të testuar rritjen e parametrave të lojës dhe ç' është më e rëndësishmja, për të arritur një shkallë pjekurie të domosdoshme për administrimin e lojës dhe marrjen e rezultatit

ku deputojnë dhe një sezoni të tejzgatur, disa futbollistë vlera e të cilëve është e njohur dhe e konfirmuar, nuk janë të përfshirë në listën e ndeshjes me Francën. Shembull për këtë, janë disa lojtarë që luajnë në Zvicër dhe në mënyrë të veçantë Hansi Agolli, i cili vetëm një ditë përpara grumbullimit me Francën ka zhvilluar finalen e Kupës së Azerbajxhanit, duke e fituar atë. Së treti, duke përfutuar në një farë mëyre edhe nga fakti, se për shkak “mbipopullimi” të kontigjentit të lojtarëve, kjo situatë u krijon mundësinë disa futbollistëve të rinj që të tregojnë vlerat e tyre, në ekipin kombëtar. Me hir apo me pahir, trajneri kuqezi, ka gjetur një ekuilibër brenda grupit dhe kërkon që të marrë gjithsesi më të mirën nga kjo ndeshje. Duke e kthyer në favorin e vet të gjithë situatën, teksa i vë përpara kontigjentit që ka në dispozicion, një kundërshtar luksi, Francën. Një gjigand i futbollit botëror, për t’u ndeshur me të cilin, nuk është e nevojshme që të përdorësh shumë metoda për të karikuar skuadrën.

të lartë si teknike ashtu edhe taktike. Pa harruar edhe përgatitjen e lartë fizike që posedon kjo skuadër. Në këtë aspekt, të vetmet “aleatë” që ka Shqipëria në këtë ndeshje, është fakti, që jemi



Pritshmëritë e një ndeshjeje të vështirë

Gjithmonë kur skuadra kombëtare, luan përpara publikut të saj, impenjimi është maksimal nga që edhe pritshmëritë, nga ana e tifozëve janë të mëdha. Për më tepër që tashmë “steka është ngritur lart” dhe ekipi kombëtar falë edhe paraqitjeve shumë të mira në këtë edicion, përfshi edhe miqësoret, ka krijuar një profil simpatik tek i cili besojnë të gjithë tifozët tanë. Por edhe tkurren në një farë mënyre, të gjithë kundërshtarët. Sepse të gjithë janë të ndërgjegjshëm, që në futbollin modern nuk ka rastësi. E aq më tepër, që ato të përsëriten në disa ndeshje rradhazi, siç ka ndodhur me kombëtaren shqiptare të futbollit, vitin e fundit. Kundërshtarët, janë një skuadër e cila ka brenda vetes, mjaft futbollistë të një superklasi, të aftë të godasin dhe venë në vështirësi çdo kundërshtar që kanë përpara. Trajneri i Shqipërisë De Biassi, në një intervistë të dhënë përpara disa kohësh, i ka konsideruar ata si një ekip me një ekuilibër të jashtëzakonshëm dhe me një përgatitje

në fund të edicionit dhe sigurisht edhe futbollistët e Francës ndjehen të lodhur (të mos harrojmë se shumica e tyre kanë zhvilluar një edicion futbollistik, shumë impenjativ ku gjithmonë i është dashur që të jenë në qendër të vëmendjes dhe vetëm të fitojnë. Dhe së dyti, mungesa e impenjimit maksimal, që shpesh vjen në ndeshje të tilla miqësore nga ana e skuadrave të mëdha si Franca. Por vetëm kaq. Gjithçka tjetër, na ve përballë një kundërshtari, i cili duke qenë edhe mikpritës i Kampionatit European sigurisht që ka objektiva të mëdha, pse jo edhe për të përsëritur suksesin e viteve 1984 dhe 2000, kur ka arritur ta ngrrejë Kupën, e këtij kompeticioni. Kujtoni fjalët e trajnerit të tyre Deshamps i cili pas përfundimit të ndeshjes me Shqipërinë në Rene, pasi vlerësoi mjaft lojën dhe paraqitjen e skuadrën tonë kombëtare dhe i “tërhoqi veshin” skuadrës së tij, pikërisht për faktin se nuk kishte dhënë maksimumin e në fushën e lojës. Franca, duke patur një nivel të lartë fizik dhe teknik është në gjendje që të mbajë nën presion gjatë gjithë kohës. Edhe



Duke e kthyer në favorin e vet të gjithë situatën, teksa i vë përpara kontigjentit që ka në dispozicion, një kundërshtar luksi, Francën. Një gjigand i futbollit botëror, për t’u ndeshur me të cilin, nuk është e nevojshme që të përdorësh shumë metoda për të karikuar skuadrën



E para vjen në nëntorin e largët të vitit 1990, pra një çerekshkulli më parë, kur Shqipëria përgatitej, të shkëputej nga makthi 45 vjeçar me emrin izolim. Në atë kohë Franca, drejtohej nga një kampion i madh i si Mishel Platini dhe fitonte me një gol të shënuar nga Boli. Stadiumi “Qemal Stafa”, si gjithmonë i mbushur plot në raste të tilla, priste të ndodhte ndonjë mrekulli. Por “gjelat” fituan mbi “shqiponjat”, vendi i të cilëve po përpiqej të shkëpuste disa pranga dhe të fluturonte drejt perëndimit.

Në ndeshjen e kthimit në Francë, nuk kishte nevojë për histori. Askush në Shqipëri nuk e kishte mendjen tek futbollit. Të gjithë mendonin vetëm për politikë dhe për tu larguar nga vednsi i rrënuar.

në rast perfeksioni të kundërshtarëve për ti mbajtur “gjelat” sa më larg zonës së tyre, përsëri ata kanë shumë individë të talentuar dhe të një klasi të lartë, që mund ta “nxjerrin” golin nga pozicionet më të vështira.

Niste kështu një periudhë e vështirë dhe tepër e mundimshme për shqiptarët. Kombëtarja humbet 5-0 në Paris, duke sigluar një rezultat të thellë në disfavor të saj.

Pas 20 vjetësh pikërisht në shtator të vitit 2011, Shqipëria do të përballlet përsëri me skuadrat franceze. Janë kohëra të tjera dhe sigurisht histori të tjera. Franca e udhëhequr nga Frenk Riberi shënon dy herë brenda 20 minutave të para. Është Benzema dhe pas tij menjëherë M’Vila, që i japin fitoren francezëve. Në pjesën e dytë, goli i shënuar nga ana e Bogdanit, golashënuesit më të mirë të kombëtares tonë në të gjitha kohërat, nuk ka mjaftuar për ti vënë ata në vështirësi. Ndeshja e kthimit në Francë, ka shumë pak histori. Një Shqipëri, gati inegzistente “shkërmoqet” lehtësisht 3-0, pavarësisht se tregon shpirt të lartë gare. Ndeshja e fundit zhvilluar në Rene, ka qenë një shfaqje e bukur e kombëtares shqiptare të futbollit. Një skuadër solide, i ka hedhur “dorezën” e sfidës Francës (sa për histori, doreza e famshme që të ftonte në duel, ka “lindur” pikërisht në Francë) dhe ka qëndruar denjësisht gjatë gjithë lojës, si një kundërshtar solid. Pikërisht për këtë performancë,



Ndeshja e fundit zhvilluar në Rene, ka qenë një shfaqje e bukur e kombëtares shqiptare të futbollit. Një skuadër solide, i ka hedhur “dorezën” e sfidës Francës dhe ka qëndruar denjësisht gjatë gjithë lojës, si një kundërshtar solid

Eksperiencia e përballjeve me Francën

E fundit, ajo e miqësore në Rene, ka qenë një ekperiencë e shkëlqyer. Një ndeshje që gjithmonë trajneri De Biassi, ka dashur ta marrë shembullin e një loje të organizuar me pak gabime dhe me një shpirt të lartë gare. Të mos harrojmë se ishte Franca që na barazoi, në një ballafaqim gati të paharruar, kur ne ndodheshim në avantazh. I pyetur përpara ndeshjes delikate me Armeninë, në lidhje me mënyrën e lojës, trajneri i Shqipërisë Giani de Biassi dha këtë përgjigje: “Në qoftë se do të arrijmë të luajmë ashtu si kundër Francës në nëntor, jemi në gjendje që të mundim çdo lloj kundërshtar, në grupin tonë”. Ky besim i krijuar tek skuadra, që krejt natyrshëm na tregoi se kishte limite ende të pazbuluara, është shumë i nevojshëm që të konfirmohet edhe në ndeshjen e të shtunës, e cila do të jetë e gjashta në historinë e përballjeve Shqipëri-Francë.

ekipi ynë është përgëzuar edhe nga trajneri Didier Deshamps pas përfundimit të ndeshjes. Por sigurisht në 13 qershor do të jetë një histori tjetër...

Përtej kohës dhe parashikimeve

Pas përfundimit të saj, ndeshja që sigurisht do të hyjë në historinë e futbollit shqiptar, duke u arkivuar për t'u rihapur herë pas here. Rezultati dhe gjithçka tjetër, nuk do të jenë më enigma. Ajo që do të mbetet, është paraqitja e lojtarëve në fushën e lojës. Pikërisht këtë kërkon trajneri De Biassi dhe stafi i tij nga kjo ndeshje. Përformancë sa më të mirë të futbollistëve dhe vazhdueshmëri të ndeshjeve dhe paraqitjes pozitive. Gjithçka në shërbim të sfidave të mëdha që do të luhen në muajt shtator dhe tetor, të cilat do të përcaktojnë

shumë, në ecurinë e kombëtares shqiptare të futbollit, në një edicion krejtësisht të veçantë dhe jashtëzakonisht konkurrues, si ky i sivjetmi. Një seri rezultatesh dhe paraqitjeje mjaft pozitive, e cila është një lloj garancie, për vazhdimin e suksesshëm të edicionit kualifikues të kampionatit evropian.

Nuk do të mungojnë edhe surprizat dhe trajneri i Shqipërisë, e deklaroi një gjë të tillë: "Pavarësisht, mungesave thelbësore nga grupi kryesor i futbollistëve të kombëtares, përsëri kemi rezervuar edhe disa surpriza të cilat do të tentojmë ti aplikojmë në fushën e lojës" – tha ai. Në këtë aspekt, ne jemi të përgatitur të shikojmë edhe elementë të veçantë të lojës, të cilët mund të rezultojnë efikasë

dhe të përdorshëm edhe për katër takimet e ardhëshme të cilat në të vërtetë, duke u vlerësuar një e nga një, janë katër finale të vështira. Por të domosdoshme për t'u kaluar, me sukses, nëqoftëse kërkojmë që të prekim ëndrrën e madhe me emrin kualifikim. Nga ana tjetër, lojtarë të veçantë mund të arrijnë që me performancën e tyre të na bindin, për të qenë më pranë grupit të formacionit dhe të konsiderohen si alternativa, në ndeshjet e ardhëshme që na presin. Kjo është një mundësi e mirë për ta, po të kemi parasysh faktin se ekipi kombëtar, ka tashmë në dispozicion një korpus të plotë me shumë futbollistë, të gjithë të gatshëm për t'u aktivizuar dhe për të dhënë më të mirën në të ardhmen.

SHQIPËRI – FRANCË, JA SI ËSHTË LUAJTUR:

Kampionati Evropian

Shqipëri - Francë 0-1 (0-1)
17.11.90 - Tiranë - "Q. Stafa" - 15000
Shënues: 25' Boli

Shqipëria: Arapi, Leskaj (Ferko), Hodja, Ibro, Lekbello, Stafa, Josa, Demollari, Zmijani, Kushta, Majaci (Kaçaçi).
Tr: A. Sulaj

Franca: Martini, Peres, Kasoni, Boli, Blank, Pardo, Deshamp, Souza, Tibeuf, Ferreri, Vahirua (Zhinola).
Tr. Mishel Platini

Kampionati Evropian

Shqipëri - Francë 1-2 (0-2)
Shënues: 46' Bogdani / 11' Benzema, 18' M'Vila

Shqipëria: Ujkani, Vangjeli, Dallku, Curri (24' Lala), Teli, Cana, Skela (46' Hyka), Agolli, Bulku (69' Bakaj), Bogdani, Salihi.
Tr: J. Kuzhe

Franca: Lloris, Abidal, Kaboul, Réveillère, Evra, Diarra, Malouda (81' Martin), Ribéry, Nasri, M'Vila, Benzema.

Kampionati Evropian

Francë - Shqipëri 5-0 (3-0)
30.3.91 - Paris "Park de Prince" 30000
Shënues - 11' Souza, 20' Souza, 43' Papen (p), 63' Nallbani (a), 34' Papen

Franca: Martini, Amoros, Boli, Blanc, Duran, Fernandez, Souza (Deshamp), Kokard, Papen, Kantona, Vahirua (Bait).
Tr: M. Platini

Shqipëria: Nallbani, Zmijani, Vata, Lekbello, Gjergji, Ocelli, Dume, Demollari, Canaj, Tahiri, Kepaj.
Tr. B. Birçe

Kampionati Evropian

Francë - Shqipëri 3-0 (2-0)
Shënues: 11' Malouda, 38' Remy, 67' Réveillère
07.10.2011 Paris "Saint-Denis"

Francë: Lloris, Rami, Kaboul, Debuchy, Evra (46' Réveillère), Nasri, Cabaye (47' Martin), M'Vila, Remy, Malouda, Gomis (80' Cisse)

Shqipëria: Ujkani, Vangjeli, Lila, Dallku, Cana, Duro, Muzaka (74' Januzi), Lika (81' Lilaj), Hyka (63' Bakaj), Roshi, Salihi.
Tr. Josip Kuzhe

Trajneri De Biassi: Po përgatisim edhe surpriza



Kjo ndeshje të mos shërbejë thjesht, si një ballafaqim dinjiteti por të jetë një trampolinë e mirë, për katër ndeshjet vendimtare që Shqipëria do të zhvillojë në muajt shtator dhe tetor

Me lirshmërinë e vet të zakonshme, ai si gjithmonë është i gatshëm për të dhënë spjegime për gjithçka që i kërkohet. Trajneri i Shqipërisë, Giani De Biassi, po përgatit “fushatën” e ndeshjes miqësore kundër Francës me 13 qershor në “Elbasan Arena”. I ndërgjegjshëm për mungesat që do të ketë dhe i qartë për atë që përfaqëson Franca në futbollin botëror, ai duket i i ka mbyllur kalkulimet e fundit për këtë takim. Vizioni i trajnerit është i qartë. Mungesat e disa titullarëve për këtë ndeshje, ai do t'i kompesojë me mundësinë që do t'jua afrojnë disa lojtarëve të tjerë, për të qenë sa më pranë kandidatëve të formacionit. Pra që kjo ndeshje të mos shërbejë thjesht, si një ballafaqim dinjiteti por të jetë një trampolinë e mirë, për katër ndeshjet vendimtare që Shqipëria do të zhvillojë në muajt shtator dhe tetor. Dhe do të

jenë mjaft përcaktuese për objektivat kuqezi, të edicionit eliminator, të Kampionatit European Francë 2016. Gjatë ditëve të punës me skuadrën, ai jo vetëm ka qenë i impenjuar për të ndjekur formën dhe gjendjen aktuale të futbollistëve por ashtu siç deklaroi edhe vetë, është në gjendje për të ofruar edhe ndonjë surprizë, që mund ti befasojë kundërshtarët e vet. Dhe në këtë pikë, trajneri nuk ka “zhgënyer” kurrë.

Në një ekskluzive për “Albania Futboll magazinë”, trajneri kuqezi spjeron detajet e ndeshjes sa rradhës me Francën dhe vizionin e tij dhe të stafit, në lidhje me këtë takim.

Luajmë kundër Francës, në një ndeshje miqësore. Por a mund të quhen thjesht miqësore ballafaqime me skuadra të këtij kalibri?





PICCOLI CAPRICCI

ama[®]
C A P S U L E

Ndeshje të tilla, nuk janë mundësi për të fituar përvojë, përballë skuadrave që janë superiore ndaj nesh në aspektin teknik.

të harrojmë, fitoren në Portugali dhe barazimin kundër Danimarkës, skuadra vërtetë shumë të forta dhe me një nivel të



Çfarë pret trajneri De Biassi, nga ballafaqimi i 6 qershorit?

lartë loje dhe futbollistë të niveleve më të mira të futbollit.



Franca, si në aspektin fizik ashtu edhe në atë taktik është një kundërshtar shumë i fortë. Brenda kësaj skuadre, ka lojtarë të nivelit mjaft të lartë

Pres të verifikoj gjëndjen e shumë lojtarëve të cilët gjatë këtij viti nuk kanë patur një hapësirë të madhe për të luajtur me kombëtaren. Kjo do të jetë një mundësi mjaft e mirë për ta, për të treguar në një nivel mjaft të lartë kapacitetet dhe vlerat e tyre. Por edhe për ne, që në një farë mënyre do të kemi një test real, për disa futbollistë që i kemi në planet tona të të ardhmes.

Përse e konsideroni të tillë?

Sepse Franca, si në aspektin fizik ashtu edhe në atë taktik është një kundërshtar shumë i fortë. Brenda kësaj skuadre, ka lojtarë të nivelit mjaft të lartë. Ajo përfaqëson një futboll të shkallëve më të larta dhe për këtë arsye, është gjithmonë favorite edhe në kompeticione të rëndësishme si në Botëror ashtu edhe në European. Ajo po përgatitet që ta presë Europeanin në shtëpi dhe për këtë arsye, kërkon që ta shfrytëzojë sa më mirë këtë fushatë kualifikuese për të krijuar një grup kompetitiv që synon të shkojë sa më larg, në këtë aktivitet.

Dikur keni thënë se Shqipëria mund të mund të mundë çdo kundërshtar, në rast se do të luajë ashtu siç luajti kundër Francës. Mendoni se kjo, ka qenë ndeshja më perfekte e Shqipërisë në këtë edicion?

Çfarë të rehash, mund të presim nga kjo ndeshje. Do të ketë emra të tjerë në grup?

Në aspektin tekniko taktik, patjetër që po. Ishte një provë vërtetë e mrekullueshme përballë një skuadre, e cila në të gjitha aspektet është e shkëlqyer dhe e një niveli mjaft të lartë. Këtë nuk e kemi bërë vetëm duke luajtur kundër Francës. Nuk duhet

Ndonjë emër i ri ka dhe këtë e konfirmova por ajo që bie më tepër në sy, është mungesa e lojtarëve, që konsiderohen

teper të rëndësishëm për ne. Por kjo do ti krijojë mundësinë edhe futbollistëve të tjerë që të afrohen sa më shumë me grupin dhe të tregojnë vlerat e tyre. Një mundësi



e tillë, siç është eksperiencia me Francan e fortë, nuk është diçka që të vjen shpesh në karrierë. Për këtë arsye, kërkohet prej tyre një impenjim maksimal.



Jam i bindur se do të ecim përpara duke përmirësuar mënyrën tonë të lojës. Kjo do të jetë një ekperiencë e vlefshme, për të vazhduar në rrugën e duhur, në të ardhmen

Ka patur shumë entuziazëm dhe besim brenda skuadrës në këto ndeshjet e fundit, besim që reflektohet edhe tek tifozeria. Sa e rëndësishme është vazhdimësia e këtij entuziazmi brenda grupit edhe pas kësaj ndeshjeje?

Kjo është një ndeshje disi e veçantë, sepse do të luhet në fundin e një edicioni shumë impenjativ për futbollistët. Për më tepër që ne, për motive të ndryshme, nuk do të zgjedhim të njëjtën skuadër, me të cilën luajtëm dhe barazuam në Rene të Francës. Por siç e thashë më lart ne duhet të shikojmë anën pozitive të paraqitjes së lojtarëve të rinj.

Sa vlen kjo ndeshje, për të përgatitur katër finalat e mëdha që e presin

Shqipërinë, në muajt shtator dhe tetor, kundër Danimarkës, Portugalisë, Serbisë dhe Armenisë?

Të gjitha takimet janë të rëndësishme për ne, ndonëse, kundër Francës do të luajmë me mungesa. Megjithatë, jam i bindur se do të ecim përpara duke përmirësuar mënyrën tonë të lojës. Kjo do të jetë një ekperiencë e vlefshme, për të vazhduar në rrugën e duhur, në të ardhmen. Pavarësisht mungesave të deklaruar, jemi përgatitur edhe për surpriza, të cilat mund ta befasojnë kundërshtarin dhe kënaqin sa më tepër publikun tonë të zjarrtë.

Çdo ndeshje ka specifikën e saj, madje edhe ato miqësoret, cilat janë specifikat e ndeshjes me Francën?

Të verifikojmë se edhe pa tre pikët në lojë, sa kapacitet kemi, të përqendrohemi tek objektivi. Sa dëshirë kemi për të sakrifikuar energjitë ndaj kundërshtarëve të një force dhe cilësie më të lartë. Të mësojmë, se a do të vazhdojë të reagojë skuadra, njësoj si deri më tani.

Shqiptar edhe me pasaportë

Pëprara ndeshjes me Armeninë në një ceremoni të veçantë dhe në praninë e drejtuesve të FSHE, të stafit dhe të ekipit kombëtar, Presidenti i Republikës Bujar Nishani i dorëzoi trajnerit Giani De Biassi, dekretin për marrjen e nënshtetësisë shqiptare. Një dëshirë e kahershme e trajnerit italian, që është dashuruar me vendin tonë. Por sigurisht që marrja e nënshtetësisë dhe firmosja e saj nga ana e Presidentit të Republikës, është pjesa kryesore e kësaj procedurë. Por pajisja fizike me pasaportë, sigurisht që kërkon edhe procedura të tjera. Të cilat janë kryer këto ditë dhe pikërisht përpara ndeshjes me Francën, trajneri ka marrë edhe fizikisht pasaportën shqiptare. Këtë e konfirmon për "Albania Football Magazine" edhe zv/Sekretari i Përgjithshëm i FSHE, Besnik Çela, i cili si për një mori futbollistësh të të gjitha niveleve të ekipeve tona kombëtare, ka kryer në kohë rekord të gjitha procedurat e pajisjes me pasaportë shqiptare.



Federata Shqiptare e Futbollit

dhe



Kryqi i Kuq Shqiptar

Promovojnë:

14 Qershor, Dita Botërore e Dhuruesve të Gjakut.

Këtë vit mesazhet që do të përcillen janë:

“Faleminderit, më shpëtua jetën”
dhe

“Dhuro Falas, Dhuro Shpesh. Dhuro Gjak!”



Fushata e Kryqit të Kuq ka filluar më 1 qershor. Ndër të parët, që kanë dhuruar është dhe kryeministri i vendit në hapje të kësaj fushate.

Në vendin tonë fushata fokusohet në:

- *falënderimin për dhuruesit e gjakut për kontributin e tyre në vazhdimësi,*
- *në promovimin e mesazhit “dhuro falas, dhuro shpesh, dhuro gjak”*



Inciativa e Kryqit të Kuq Shqiptar për të promovuar dhurimin vullnetar të gjakut, realizohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e vendit. Duke njohur fuqinë e jashtëzakonshme që ka bota e futbollit në transmetimin e mesazheve, Kryqi i kuq Shqiptar në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Futbollit dëshiron të përcjellë mesazhin “Dhuro gjak – shpëto jetë” në një nga ndeshjet e rëndësishme të skuadrës tonë përfaqësuese, Shqipëri – Francë.

Shembujt nga bota e futbollit, e sportit më popullor të rruzullit, kanë treguar se efekti në masat ka qenë jashtëzakonisht i madh.



www.vas.al

FITUESIT E NJË EDICIONI TË PAZAKONTË

Tashmë sipari ka rënë, dritat janë fikur ndërsa spektatorët nxitojnë për t'ja kaluar njeri tjetrit në drejtim të daljes. Shfaqja është mbyllur. Por diskutimet për të, do të vazhdojnë gjatë, me vlerësime, me kritikë dhe shpesh me një pasion të

e bënë këtë garë më të bukur dhe më interesante. Për më tepër arriti që të vendoste një rekord në futbollin shqiptar, duke fituar pesë kampionate rradhazi, që ishte i vështirë për tu arritur nga skuadrat e mëdha të viteve 50 si Partizani apo Dinamo, e jo më në kohët moderne ku rivaliteti dhe cilësia janë rritur mjaft dhe vështirë se mund të vazhdojë hegjemonia e një skuadre të vetme. Titulli i pestë ka qenë më i vështiri por edhe më i bukur, për korçarët. E para, se vendosën një rekord, të vështirë për tu thyer dhe dyta, sepse pikërisht ky titull, u arrit me luftë, përpjekje dhe vështirësi të krijuara nga skuadrat rivale. Është një lloj si një nënë, e cila lidhet më shumë me fëmijën, që ka patur lindjen më të vështirë. Janë disa nga faktorët që i çuan korçarët, drejt suksesit të pestë dhe



jashtëzakonshëm. Kështu ndodh në teatër, opera, festival, konkurse të ndryshme. Kështu ndodh edhe në futboll. Madje diskutimet dhe debatet për të, janë gati të pafundme dhe nisin ende pa filluar gara, për të vazhduar edhe kur ajo ka përfunduar. Pra pa asnjë periudhë pushim...

Edicioni që sapo u mbyll, ishte i veçantë në llojin e tij. Ai ishte, si ato gjellët e shijshme që kanë brenda gjithçka. Nuk mungonte spektakli, golat e bukur, veprime të mira teknike dhe taktike të futbollistëve dhe skuadrave dhe mjaft ndeshje të bukura dhe me ritëm të lartë, etj. Skënderbeu ka meritën, që jo vetëm ti rezistonte deri në fund luftës me skuadrat e tjera por edhe të arrinte të thyente të gjithë kundërshtarët që duke luftuar deri në metrat e fundit

të merituar. Së pari është drejtimi dhe mirëmenaxhimi i klubit, nga ana e Presidentit Ardian Takaj. Nuk është sekret, që Skënderbeu është një prej skuadrave më të mirëmenaxhuara, të futbollit shqiptar. Më pas, vijnë kushtet shumë të mira për tu stërvitur dhe për të luajtur që skuadra ka, si në Korçë ashtu edhe në Durrës. Menaxhimi i grupit të futbollistëve dhe drejtimi profesional i stafit teknik me në krye trajnerin Mirel Josa, kanë krijuar një bazë të mirë tek e cila mund të mbështetesh. Po të shikosh ecurinë e Skënderbeut në këto vitesh vë re lehtësisht, se pak futbollistë janë shkëputur nga ky grup. Edhe ata që janë larguar përsëri janë zëvendësuar me alternative të tjera, të cilat shpesh kanë dhënë më shumë më rendiment se të parat. Padyshim, e rëndësishme është edhe atmosfera

që krijohet rreth skuadrës nga ana e tifozerisë korçare. Skënderbeu është një nga skuadrat e pakta që nuk e ndjen presionin e tifozerisë dhe punon e qetë për të përgatitur



ndeshjen e rradhës. Po ti shtosh këtyre që përmendëm më lart edhe pjekurinë e mjaft futbollistëve dhe të “mësuarit” me trofe, e kupton thelbin e suksesit të kësaj skuadre. Madje duke theksuar edhe faktin e pranuar nga të gjithë, se pavarësisht rritjes mjaft të madhe të futbollit të rivalëve të saj, përsëri Skënderbeu ishte skuadra që kishte nivelin më të lartë të lojës që prodhohet në Kategorinë Superiore të futbollit shqiptar. Pjekuria e kësaj skuadre dhe qetësia që rrezatohej edhe në momente të vështira për korçarët, si nga pankina ashtu edhe nga presidenca ndikuan mjaft që ajo të ishte e qetë dhe aspak nervoze, edhe në ato momente të kampionatit kur u duk sikur korçarët po “zverdheshin” e po dorëzoheshin nga lufta për titull. Në një edicion të tillë, që vazhdoi gati si një përrallë dhe do të mbahet mend gjatë për rivalitetin e tejskajshëm, Skënderbeu ja doli të triumfojë përsëri dhe këtu vetëm për rastësi apo fat, nuk mund të flasim. Sepse thënë në gjuhën popullore: “Të përplasit pesëshja në surrat dhe të kyç gojën”.

Po të tjerët. Vështirë se ata, që arritën Europën, duhet të quhen humbës, pas këtij edicioni të jashtëzakonshëm. Kukësi, i shkoi më pranë se kurrë titullit kampion sivjet. Por marshi më tepër që kërkohet për të kapërcyer Skënderbeun, mungoi. Presioni mbi skuadrën, ishte

i madh dhe ndoshta ai ndikoi që ajo e presionuar, pikërisht në momentet që duhej të jepte maksimumin u tkurr dhe nuk arriti atë që pritej prej saj. Sa i takon finales së dytë rradhazi që humbi për Kupën e Shqipërisë, kjo nuk mund ta penalizojë një edicion të luftuar për disa faktorë. Së pari, sepse finalja është gjithmonë një finale, ku shanset janë përafërsisht të barabarta për të dyja skuadrat. Së dyti, sepse Laçi, nuk ishte një finalist dosido por një skuadër që vetëm dy vjet më parë e kishte ngritur lart Kupën e Shqipërisë, pra kishte eksperiencën e nevojshme për të arritur një sukses të tillë. Dhe së treti, sepse kundërshtari i tij, thjesht bëri një lojë më të mirë dhe e meritoi fitoren në të gjitha drejtimet.

I treti u rendit Partizani, që ndryshe nga edicioni i kaluar, sivjet ja doli të jetë pjesë e Kupave të Europës, një sukses i merituar i skuadrës së kuqe. I presidentit të skuadrës Gazmend Demi, që brenda dy vjetësh arriti që skuadrën që vinte nga kategoria e parë ta çonte në Kupat e Europës. Padyshim që meritë e madhe i takon edhe trajnerit Shpëtim Duro, që diti të përballojë denjësisht dhe profesionalisht presionin që binte me skuadrën. Kuptohet që për emrin që ka, tifozerinë e shumtë në të gjithë Shqipërinë dhe për “urinë” që ky klub ka për trofe, sigurisht që pritshmëritë kanë qenë edhe më të mëdha. Por të mos harrojmë se edhe Stambolli nuk u ndërtua në një ditë, thotë një fjalë e vjetër.

Së fundmi por jo i fundit, është Laçi. Një skuadër simpatike, e një qyteti të vogël, që dikur përflitej se të të mundte me çdo kusht dhe mënyrë, në fushë e vet. Ndërsa sot, vlerësohet për futbollin e bukur dhe produktiv që ka treguar dhe është në gjendje të marrë pikë pa ju dridhur qerpiku edhe në fushat e skuadrave më të mira të kampionatit. Një skuadër e ndërtuar me kujdes e me mjaft zgjedhje pikante nga ana e Presidentit Pashk Laska, që arriti të fitojë trofeun e dytë të rëndësishëm të sezonit. Drejtimi teknik dhe me mjaft kopetencë i një trajneri të ri por të përkushtuar si Armando Cungu, i cili në drejtimin e tij, si tek Kukësi ashtu edhe tek Laçi, ka lënë pas një histori suksesi të padiskutueshëm.

Statistikat e futbollit, ndryshimi i sivjetëm



Lysien Nurishmi

Statistikat janë gjithmonë të rëndësishme për të bërë analizën, e një edicioni futbollistik. Madje një analizë e plotë dhe profesionale është e vështirë për tu kryer në mungesë të tyre. Specialistët, trajnerët, analistët dhe gazetarët, nëpërmjet tyre, kanë mundësinë që të bëjnë krahasime dhe të ndjekin në mënyrë profesionale arritjet dhe mosarritjet e një edicioni. Larg klisheve dhe batutave por vetëm nëpërmjet fakteve të pamohueshme, që lexohen nga statistikat, mund të bëhet e mundur nxjerrja e konkluzioneve të sakta për një edicion të gjatë futbollistik.

i të cilit, ka krijuar një lehtësi të jashtëzakonshme në komunikim. Edhe në shkrime të tjera, kemi folur për vlerat dhe risitë që ka krijuar ai, në futbollin shqiptar. I rëndësishëm është ky sistem edhe për nxjerrjen e statistikave, sa më të sakta, në lidhje me edicionin futbollistik. Një mundësi e mirë është kjo, në mënyrë të veçantë edhe për klubet e futbollit, të cilët nëpërmjet account që kanë për të hyrë në sistem kanë mundësinë që të nxjerrin konkluzione të qarta për veprimtarinë futbollistike të edicionit. Departamenti i Garave, në Federatën Shqiptare të Futbollit i ka



Një ndihmë të madhe në këtë drejtim, na jep edhe sistemi COMET, aplikimi

kushtuar dhe vazhdon ti kushtojë, një interes mjaft të madh nxjerrjes së të



teknike që të kthehet me fitore nga udhëtimi jashtë fushës së saj. Në këtë edicion futbollistik në Kategorinë Superiore, janë shënuar 52 fitore të ekipeve udhëtuese. Duke përdorur metodën e krahasimit, arrijmë në konkluzionin se në raport me edicionin e kaluar futbollistik, janë shënuar 9 fitore më shumë.

Interesante janë statistikat, edhe sa i takon golave të shënuar gjatë një ndeshjeje futbolli. Gjatë këtij edicioni,

sipas statistikave rezultojnë se janë shënuar gjithsej 377 gola në Kategorinë Superiore. Mesatarja e golave është 2.1 gola për ndeshje dhe i bie afërsisht një gol për çdo pjesë loje (ose saktësisht 1 gol i shënuar çdo 47 minuta). Gjithsesi kjo është një mesatare e ulët golash, po të kemi parasysh të dhënat statistikore të kampionateve elitare në Europë. Statistika të tilla, krahasuar me disa nivele kampionatesh europiane, bëhen mjaft interesante dhe të kuptueshme edhe për publikun e gjerë dhe jo vetëm për pjesën profesioniste të futbollit. Ato japin të dhëna, për mënyrën se si konceptohet futbolli sulmues në skuadrat tona dhe se si është ai, në raport me disa nivele futbolli të kampionateve të tjerë në Europë. Sigurisht, një studim i mirëfilltë shkencor, nuk do të ishte e plotë në rast se nuk do të shoqërohej edhe me të dhëna të tjera plotësuese, siç mund të jenë goditjet në portë, rastet e shtyllave apo kontrolli i topit por gjithsesi ai të krijon një ide të përgjithshme në lidhje me këtë. Golashënuesi më i mirë i kampionatit, siç dihet është shpallur futbollisti kroat i Kukësit, Pero Pejiç, që ka shënuar 31 gola. Ai është aktivizuar në 35 ndeshje të Kampionatit Kombëtar të Kategorisë Superiore (interesant është fakti që ka munguar vetëm në një takim, që skuadra e tij ka zhvilluar

dhënave statistikore, për një edicion futbollistik, në mënyrë që të nxjerrë konkluzione sa më të pjekura dhe profesionale për të. Gjithashtu këto të dhëna, jo vetëm që kanë nisur dhe po bëhen publike por nga ana tjetër, ato i vihen në dispozicion edhe Departamenteve të tjera të FSHF, të interesuara për to. Ndër to mund të përmendim Sektorin e Edukimit, Sektorin e Gjykimit, Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun etj.

Kategoria Superiore, të veçantat e sivjetme

Është folur shumë për risitë që solli sivjet gara, sidomos në Kategorinë Superiore, ku deri në javët e fundit, u luftua nga katër apo pesë skuadra për titullin kampion dhe vendet që të çojnë në Kupat e Europës. Ajo që të bie në sy, gjatë kësaj periudhe dhe që vërtetohet në një farë mënyre shkallën e vështirësisë të Kampionatit Kombëtar të Kategorisë Superiore, janë edhe fitoret jashtë fushës. Sigurisht, ka vite që në futbollin shqiptar, është ç'rrenjosur "tabuja" e dikurshme e "pathyeshmërisë" së skuadrave vendase. Në Kategorinë Superiore dhe në atë të Parën, çdo skuadër udhëtuese, i ka mundësitë



Gjatë këtij edicioni, sipas statistikave rezultojnë se janë shënuar gjithsej 377 gola në Kategorinë Superiore. Mesatarja e golave është 2.1 gola për ndeshje dhe i bie afërsisht një gol për çdo pjesë loje ose saktësisht 1 gol i shënuar çdo 47 minuta



sivjet), me një mesatare 0.88 gola për ndeshje. Gjithashtu për këtë edicion është shpallur edhe ekipi “Fair Play”, që është Skënderbeu i Korçës.

Tifozët në stadium dhe mosha mesatare

Një tjetër problem që ka shqetësuar futbollin shqiptar, sidomos pas viteve 90, ka qene edhe pjesëmarrja e tifozëve tanë në stadium. Të mësuar me një fluks të jashtëzakonshëm të tifozerisë shqiptare para viteve 90, zbrazja e stadiumeve ishte një fenomen i cili shqetësonte mjaft, specialistët dhe median. Nëpërmjet statistikave të fundit, ne jemi në gjendje, që menjëherë të nxjerrim një konkluzion më të qartë të pranisë së tifozëve në stadiumet shqiptare. Nga një kalkulim statistikash, rezulton që ndeshjet e këtij sezoni janë ndjekur nga 676 mijë tifozë. Sigurisht nuk mund të flasim për shifra 100% të sakta për shkak, se në Shqipëri ende nuk përdoren biletat me bar code (përjashtim bëjnë vetëm ndeshjet ku luan kombëtarja shqiptare e futbollit), nëpërmjet të cilave, mund të japësh numrin e saktë, të tifozëve të pranishëm në stadium. Në fakt kjo, është një temë shumë e rëndësishme e lidhur mbështetjen që i bëhet futbollit dhe interesit për të.

Interesante, janë edhe statistikave e

tjera që kanë lidhje me moshën e futbollistëve nëpërmjet të cilave do të kemi mundësinë, të shikojmë aktivizimin dhe moshën e futbollistëve të rinj që debutojnë në futbollin shqiptar. Në Kategorinë Superiore mosha mesatare është 26.3 vjeç. Dy skuadrat, që mund të konsiderohen si “humbëset” e këtij edicioni (për shkak se do të luajnë edicionin e ardhshëm në Kategorinë e Parë), kanë moshën mesatare me të re, gjatë këtij edicioni. Dhe përballë saj, ka edhe një statistikë tjetër, e cila e bën edhe më interesante këtë argument. Kjo ka lidhje me moshën më të lartë mesatare. Dy skuadrat, të cilat kanë fituar respektivisht titullin kampion në Kategorinë Superiore dhe Kupën e Shqipërisë (dy trofetë më të rëndësishëm të një edicioni futbollistik në vend). Janë pikërisht ato të cilat kanë edhe moshën më të madhe mesatare, Skënderbeu dhe Laçi, 28,2 vjeç.

E ardhmja e statistikave në FSHF

Sektori i Garave në Federatën Shqiptare të Futbollit, e ka vlerësuar dhe e vlerëson shumë nevojën e statistikave dhe publikimit të tyre. Ai por përgatit një draft, nëpërmjet të cilit do të bëhet i mundur përmirësimi dhe përpunimi i të dhënave, të cilat nuk do të jenë vetëm pronë e institucionit por edhe e specialistëve, mediave dhe në mënyrë



Nëpërmjet statistikave të fundit, ne jemi në gjendje, që menjëherë të nxjerrim një konkluzion më të qartë të pranisë së tifozëve në stadiumet shqiptare. Nga një kalkulim statistikash, rezulton që ndeshjet e këtij sezoni janë ndjekur nga 676 mijë tifozë

të veçantë të klubeve. Madje, këta të fundit, kanë mundësinë që nëpërmjet tyre, të nxjerrin konkluzione sa më të qarta në lidhje me atë, që skuadrat kanë arritur në edicionin futbollistik, që sapo u mbyll. Është menduar që në përfundim të çdo edicioni futbollistik, të përgatitet një lloj vjetari statistikor, me të dhëna që vijnë nga Kampionati Kombëtar i Kategorisë Superiore dhe më pas edhe për Kampionatet e Kategorive të tjera. Publikimi i tyre, do të jetë një risi krejtësisht e veçantë dhe e domosdoshme. E njëjta gjë, do të jetë edhe e mundur edhe në mënyrë elektronike. Në bazë të të dhënave të ardhura nga sistemi COMET, në të ardhmen do të përpiqemi për të përmirësuar edhe më cilësinë dhe shumëllojshmërinë e tyre, duke përdorur në mënyrë të veçantë metodën e krahasimit.

Të dhëna statistikore:

Fitoret, golat, golashënuesi:

- Për sezonin futbollistik 2014-2015, në Kategorinë Superiore ka patur 52 fitore të ekipeve jashtë fushave të tyre. Per sezonin futbollistik 2013-2014 ne kategorise superiore ka patur 43 fitore te ekipeve jashte.
- Për sezonin 2014-2015 në Kategorinë Superiore, janë shënuar 377 gola.
- Mesatarja është 2.094 gola për ndeshje.
- Mesatarja 1 gol per 47 minuta
- Golashënuesi më i mirë i edicionit 2014-2015 në Kategorinë Superiore është shpallur Pero Pejic me 31 gola. Ai është aktivizuar në 35 ndeshje dhe ka marrë 2 kartona të verdhë.
- Ekipi Fair Play, është shpallur ekipi kampion i Skenderbeut

Pjesëmarrja e tifozëve:

- Skënderbeu është skuadra që në kategorinë Superiore ka patur më

shumë tifozë të pranishëm në stadium. Mesatarja është afro 3000 tifozë për ndeshje.

- Numri total i tifozëve që kanë ndjekur 180 ndeshjet e Kategorisë Superiore (këtu nuk janë marrë parasysh ndeshjet ku fushat pritëse kanë qenë të dënuara), përafërsisht është 676.000 tifozë.



Kartonat:

- Për sezonin futbollistik 2014-2015, në Kategorinë Superiore janë marrë gjithsej kartona të verdhë 826.
- Mesatarja 4,5 kartona të verdhë për ndeshje
- Për sezonin futbollistik 2014-2015, në Kategorinë Superiore janë marrë gjithsej kartona te kuq 62.
- Mesatarja 0,35 kartona të kuq për ndeshje.

Mosha e futbollistëve:

- Mosha mesatare e futbollistëve pjesëmarrës në Kategorinë Superiore është 26,3 vjeç.
- Ekipet me mesatare më të ulët moshe, janë Elbasani dhe Apolonia 24,9 vjeç.
- Ekipet me mesatare më të lartë moshe, janë Skënderbeu dhe Laçi 28,2 vjeç.



Është menduar që në përfundim të çdo edicioni futbollistik, të përgatitet një lloj vjetari statistikor, me të dhëna që vijnë nga Kampionati Kombëtar i Kategorisë Superiore dhe më pas edhe për Kampionatet e Kategorive të tjera

Hito Hitaj, një jetë me futbollin



Këto ditë ai ka thënë zyrtarisht “mjaft”, për dalë në pension. Një jetë e tërë e përkushtuar për futbollin, lojën më të bukur në botë. Në një ceremoni prekjëse, organizuar nga Federata Shqiptare e Futbollit, në prani të drejtuesve të saj miqve, familjarëve dhe kolegëve ai mallëngjyer, ka bërë edhe “ndarjen” zyrtare, me një karrierë të shkëlqyer dhe me një kontribut për tu patur zili, në shërbim të futbollit. Por pavarësisht kësaj,

u zhvillua për nder të tij, Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit armand Duka pasi ka vlerësuar kontributin e madh të Hito Hitajt në futboll e ka mbyllur me këto fjalë: “Por largimi i Hitos nga futbollit, është thjesht një çështje administrative. Ai do të qëndrojë gjithmonë pranë futbollit për të na ndihmuar me ekperiencën dhe mendimet e tij. Njerëz të tillë, janë gjithmonë të vlefshëm për sportin tonë të dashur dhe për FSHF”.

Hito Hitaj, nisi të bëhej i njohur dhe popullor për futbollin shqiptar në mesin e viteve 70, kur mori drejtimin e



futbollit do të vazhdojë të ketë nevojë për shërbimet e tij, për mendjen dhe idetë e tij. Për ekperiencën e madhe, të cilën ai e fitoi duke punuar vazhdimisht pranë futbollit dhe duke ju përkushtuar atij. Gjatë ceremonisë së ngrohtë që

Luftëtarit të Gjirokastrës. Shumë shpejt, skuadra e qytetit të njohur jugor filloi të dallonte për mënyrën e saj të lojës dhe për stilin elegant me të cilin përfaqësohej në futbollin shqiptar. Tashmë specialisti i futbollit, emrin e të cilit do ta gjeje jo

rrallë edhe nëpërmjet analizave teknike në gazetën “Sporti Popullor”, kishte nisur të përgatiste sfidat e tij. Luftëtari shumë shpejt, u shndërrua në një ekip simpatik për tifozët në të gjithë Shqipërinë dhe vrastar për kundërshtarët. Boni, Shoni, Seiti, Kalluci dhe në veçanti Braho,

me teknikën e lartë individuale të disa futbollistëve të spikatur. Luftëtari evidentohet për stilin e veçantë dhe simpatik, që nisi të tërhiqte sportdashësit anembanë Shqipërisë.



Nën drejtimin e Hitajt, në rradhët e Luftëtarit u evidentuan shumë lojtarë të talentuar të cilët veshën edhe uniformën e ekipit kombëtar, madje pas hapjes së Shqipërisë, luajtën edhe me skuadra të njohura jashtë. Sefedin Braho, Arjan Xhumba, Arjan Bellai, Altin Haxhi, janë një pjesë e emrave, që shkruan historinë e tyre me kuqezinjtë. E mbi të gjithë, spikaste talenti i padiskutueshëm i të paharruarit Lefter Millo, një prej gjigandëve të futbollit shqiptar.

Së bashku me skuadrën e tij, edhe vetë tekniku rritej profesionalisht. Ai ka kryer gjatë asaj periudhe të gjitha kurset që organizoheshin në Shqipëri, me lektorë vendas dhe të huaj.



Nën drejtimin e Hitajt, në rradhët e Luftëtarit u evidentuan shumë lojtarë të talentuar të cilët veshën edhe uniformën e ekipit kombëtar, madje pas hapjes së Shqipërisë, luajtën edhe me skuadra të njohura jashtë. Sefedin Braho, Arjan Xhumba, Arjan Bellai, Altin Haxhi, janë një pjesë e emrave, që shkruan historinë e tyre me kuqezinjtë

ishin pjesë e një skuadre, e cila nisi me shumë dinjitet të konkurronte mes më të mirave të futbollit shqiptar.

Dhe një gjë e tillë, nuk ishte e lehtë në futbollin shqiptar, ku dominonin emrat e mëdhenj si Partizani, Dinamo, Tirana, Vllaznia, etj. Luftëtari i Gjirokastrës, nën drejtimin e Hito Hitajt, arriti të shpallej nënkampion i Shqipërisë, në kampionatin kombëtar të vitit 1979. Një gjë, gati e pamenduar për një skuadër të një qyteti të largët. Dhe të mos harrojmë që ishin vitet më të arta të futbollit shqiptar, ku shumë skuadra nisën të rivalizonin fort, me emrat tradicionale duke e bërë konkurrencën që të rritej në maksimum.

Mënyra e lojës së Luftëtarit e frymëzuar nga idetë e trajnerit të tij, ishte interesante dhe bazohej në lojën e shpejtë gërshtuar



Pas viteve 90, ai drejton për disa vjet klubin e Luftëtarit, ndërkohë që arrin edhe një tjetër kulm në karrierën e tij, teksa për një periudhë dy vjeçare, bëhet trajner i ekipit kombëtar dhe drejton këtë skuadër së bashku me trajnerin Neptun Bajko.

Në vitin 1997, nis punën në Federatën Shqiptare të Futbollit, ku për një periudhë të gjatë drejtoi sektorin e garave. Për ta mbyllur, karrierën e tij në Sektorin e Edukimit, duke u bërë pjesë e kurseve të panumerta për kualifikimin e kuadrit trajner.



 **SHTËPIAIME**

KREDI PER SHTEPI



Telefoni pa pagesë në

+ 0800 0800



Telefoni në

+ 355 4 238 9090



Dërgoni e-mail tek:

duakredi@unionbank.al

Apliko për Kredi



**Apliko
on-line**

www.unionbank.al



UNIONBANK

Financim për shtëpi

Kredi për shtëpi me **4.4%** interes
për vitin e parë

+ financim shitesë për • Zgjerim • Rinovim • Mobilim



Kursi UEFA B me trajnerë nga Kosova

Ka nisur në këtë javë, në Qendrën Stërvitore në Kamëz, Kursi UEFA B. E veçanta e tij është se ky kurs zhvillohet vetëm me trajnerë kosovarë. Janë gjithsej, 38 specialistë futbollit të cilët do të pajisen në fund të kursit me diplomat B. Për shkak të largësisë, kursi do të jetë intensiv. Ky kurs, është pjesë e programit vjetor, të Sektorit të Edukimit në Federatën Shqiptare të Futbollit. Prej kohësh FSHF, po bashkëpunon për të rritur nivelin teknik të specialistëve nga Kosova, duke organizuar kurse të niveleve të ndryshme kualifikimi enkas për ta.



Presidenti i FSHF ngushëllon familjen Mavraj

Thellësisht i prekur nga humbja e jetës së njeriut tuaj të dashur, më lejoni që në emrin e Federatës Shqiptare të Futbollit, Komitetit Ekzekutiv dhe në emrin tim, t'ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e babait tuaj. Në këtë moment të vështirë për familjen Mavraj, ne të gjithë, si komunitet futbollit në Shqipëri, ndodhemi pranë jush, për t'ju lehtësuar sadopak dhimbjen. Sigurisht,

që humbja është e rëndë e për ta kapërcyer, me ndihmën e Zotit, juve ju duhet shumë forcë dhe vullnet. Shpresojmë shumë, që ta kapërceni me sa më pak dhimbje një çast të tillë të vështirë për çdo familjar dhe bir. Ju pastë lënë kujtimet më të mira dhe u prehte në paqe. Edhe njëherë pranoni ngushëllimet më të sinqerta edhe në emër të ekipit kombëtar dhe stafit të tij. Me respekt
Armand Duka
President i FSHF



Qendrimi i FSHF

Komisioni i Etikes dhe Disiplines, i jep ne tavoline Rusise 3 pike, ne lidhje me ndeshjen Mali i Zi- Rusi duke denuar keshtu me humbje 0-3 Malin e Zi. FSHF mendon se ky vendim eshte tejet i drejte : Ne perputhje me standardet dhe rregullat e UEFA-s. Duke marre shkas nga ky vendim FSHF thekson qe ne rastin e ndeshjes Serbi-Shqipëri Komisioni i Etikes dhe Disiplines nuk aplikoi te njejtin standart gjykimi, sepse dhuna ne stadiumin Partizani te Beogradit ishte me ekstreme dhe e shoqeruar gjithashtu me thirrje raciste. Pamjet e goditjeve te lojtareve tane me karrike dhe sende te forta, fishekzjarret dhe hyrja ne fushe e tifozëve ne prani te 5000 policeve jane nje argument i padiskutueshem qe vendi organizator deshtoi per mbarevajtjen e nje ndeshjeje normale futbollit mbeshtetur ne rregullat e UEFA-s.



Shorti i EURO 2017 për femrat

Kombëtarja e femrave ka njohur kundërshtarët e saj për eliminatorët e Kampionatit Evropian. Të hënën në Nion të Zvicrës, është hedhur shorti për UEFA Women's EURO 2017. Vajzat e drejtuara nga trajneri Altin Rrakli janë pjesë e grupit të tretë ku ndodhet edhe Franca, Ukraina e Rumania. Skuadra e Rraklit ka si kundërshtar më të vështirë Francën, që është pjesë e fazës finale rregullisht prej vitit 1997. Vajzat franceze renditen të dytat në klasifikimin e UEFA-s. Faza finale do të mbahet në vitin 2017 në Holandë dhe do të ketë 16 kombëtare. Ndeshjet e Kombëtares:

- 22.10.2015 Shqipëri-Greqi
- 27.10.2015 Rumani-Shqipëri
- 27.11.2015 Shqipëri-Francë
- 26.01.2016 Greqi-Shqipëri
- 04.03.2016 Shqipëri-Ukrainë
- 08.04.2016 Ukrainë-Shqipëri
- 02.06.2016 Shqipëri-Rumani
- 09.09.2016 Francë-Shqipëri



Seminari për arbitret femra

Uzhvillua me sukses seminari dy ditor për arbitrat femra të moshës 17-23 vjeçe. Qëllimi i këtij seminari është kualifikimi i vajzave për një perballje dinjitoze, integtrimin gradual të tyre në futbollin e meshkujve si dhe seleksionimi i tyre në

varesi te parametrave me te pranueshme fizike dhe teorike ne menyre qe te jene ne nje nivel sa me te larte per tu perfaqesuar ne rangjet e gjyqtares te FIFA-s . Vajzat ishin rreth 20 te ardhura nga Durresi, Shkodra, Elbasani dhe Durresi te cilat kryen seminarit dy ditor i cili u nda ne teorik dhe praktik. Zhvillimi i ketij seminarit ka qene kete vit per te paren here i zhvilluar dy ditor dhe me standard me te larte se paraardhesit. (u shpreh lektori I seminarit Plarent Kotherja.



Flamurtari fiton kampionatin e Futsall

Ekipi i Flamurtarit ka fituar Kampionatin Kombetar te futsallit per sezonin 2014-2015. Finalja e play-off u luajt diten e enjte ndermjet Tiranës dhe Flamurtarit ne pallatin e sportit “Tomor Sinani” ne qytetin e Elbasanit. Ndeshja perfundoi me rezultatin 5-2 per Flamurtarin. Trofeu i kampionit eshte dorezuar nga ish-futbollisti i njohur Vasillaq Zeri.



Nisin punimet në “Loro Boriçi”

Filloi sot rikonstruksioni i Stadiumit Loro Boriçi ne Shkoder. Kryeministri Edi Rama, Presidenti i FSHF,

Armand Duka dhe prezantuesit e projektit çelen sot zyrtarisht fillimin e ketij stadiumi kaq te mirepritur nga tifozet kuqezi por edhe nga populli Shqiptar per nje prezantim sa me dinjitoz te kombetares sone. Punimet do te zhvillohen me turne, ndaj shpresohet qe te jete gati per ndeshjen me Serbine, ne tetor te ketij viti.



Kosova do të pranohet në FIFA në vitin 2016

Përfaqësuesja e Kosovës mund të marrë pjesë në kualifikueset për Kampionatin Botëror që zhvillohet në Rusi në vitin 2018. Kështu të paktën ka thënë në një prononcim për mediat, presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka. «Unë jam shumë i bindur se Kosova në vitin 2016 do të jetë anëtare e UEFA-s dhe FIFA-s. Kam biseduar me autoritet e UEFA-s. Kosovës mund t'i rezervohet një vend për shortin e Kampionatit Botëror në Rusi, në vitin 2018, Uroj që mos të jemi në një grup me Kosovën. Kontributi i presidentit Fadil Vokrri, është shumë i madh në pranimin e Kosovës në UEFA e FIFA. Është lajm i rëndësishëm për futbollin shqiptar dhe shtetin e ri të Kosovës», deklaroi Armand Duka. Foli edhe numri një i futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. «Kosova është shumë afër pranimit. Jemi duke e përpiluar agjendën së bashku me UEFA-n. Në çdo hap jemi konsultuar me Armand Dukën, të cilin e falënderojë për kontributin e dhënë», deklaroi Vokrri.



Kombetarja U-16 fiton “UEFA Development 2015”

Kombetarja U-16 e drejtuar nga trajneri Alban Bushi ka fituar edhe ndeshjen e trete te “UEFA Development 2015”, duke u shpallur fitues te ketij turneu. Ekipi kuqezi ka fituar 1-0 perballe Qipros me nje gol te shenuar ne fund te pjeses se pare nga sulmuesi i talentuar Rolando Zenuni. Kjo ishte fitorja e trete radhazi per trajnerin Bushi ne drejtimin e ekipit kombetar. Ndeshjen e pare fituam 3-1 perballe kombetares U-16 te Malit te Zi, ndeshjen e dyte e fituam 1-0 perballe kombetares se Armenise dhe diten e sotme perballe kombetares U-16 te Qipros. ish-futbollisti i njohur Vasillaq Zeri.



Ali Demi fiton Kupen e Shqiperise ne Futsal

Te dielen me date 10 Maj 2015 ne pallatin e sportit “Asllan Rusi” ora 19:00 eshte luajtur finalja e Kupes se Shqiperise, ne futsal e cila u zhvillua midis skuadres “Ali Demi” dhe “Flamurtari”. Ndeshja kishte rivalitet dhe u zhvillua nje loje e forte nga ekipet. Koha e rregullt perfundoi me rezultatin e barabarte 1-1 dhe me penallti ka fituar skuadra “Ali Demi” me rezultatin 4-2. Medaljet dhe Kupen e Shqiperise e dorezoi anetari i Komitetit Ekzekutiv te FSHF, Vasil Bici. Me kete fitore

Uji i Skuadrës
Kombëtare
Shqiptare
të Futbollit



TEPELENE

Për t'u ndjerë çdo ditë në formë



Nr. 1 në Cilësi

Përmbajje të ulët natriumi

Vetë diuretike

1 lehtë



te merituar ekipi i "Ali Demit" me futsal shton edhe nje trofe te rendesishem ne arkivin e vet duke treguar se mbetet skuadra me elitare ne futbollin e salles.



Gramshi ngjitet ne Kategorine e Pare

Gramshi pas fitores 5-1 me ekipin e Gramozit eshte shpallur fitues per Kategorine e Dyte Grupi B. Ekipi gramshiot, dje ka zyrtarizuar rikthimin ne Kategorine e Pare, pasi per disa jave ishte ne krye te renditjes. Ndeshja e luajtur ditën e diele, e planifikuar qe te luhej ne oren 16:00 ka filluar me vonese, pasi kishte reshje te dendura bresheri. Finalja per titullin kampion te Kategorise se Dyte do te luhet midis Gramshit dhe Korabit.



Prezantohen logot e reja dhe brandi i Superiores

Sot paradite në Federatën Shqiptare të Futbollit, me iniciativën e kësaj të fundit, u mblodhën përfaqësuesit e klubeve të Kategorisë Superiore. Takimi u drejtua nga Sekretari i Përgjithshëm Ilir Shulku. Në qendër të takimit ishte diskutimi në lidhje me logon e ardhëshme të kampionatit kombëtar të Kategorisë Superiore dhe të Kupës së Shqipërisë. Pas prezantimit të tyre, në disa variante, përfaqësuesit e klubeve bënë sygjerimet

përkatëse. Në takim morën pjesë, Drejtori i Departamentit të Marketingut Gazmend Malo, i Garave Lysien Nurishmi dhe i Departamentit të PR Jona Dervishi.



Komiteti Ekzekutiv merr vendime të rëndësishme

Sot në Federatën Shqiptare të Futbollit, nën drejtimin e Presidentit Armand Duka, është mbledhur Komiteti Ekzekutiv, i cili ndër diskutime produktive të ndryshme mori këto vendime të rëndësishme:

- Miratohet fillimi i kampionatit te pare kombëtar të minifutbollit.
- Ndërtimin e një fushe futbollit për të verbërit, një lajm ky jashtëzakonisht i mirë për këtë komunitet të cilët tashmë do të kenë një aktivitet shumë domethënës që ndihmon si në aspektin fizik por mbi të gjitha për atë social. FSHF do të investojë pa kursim për plotësimin e kërkesave të tyre.



Terbuni dhe Bylis, ngjiten ne Kategorine Superiore

Kane perfunduar ndeshjet e Kategorise se Pare me dy grupet respektive. Ne grupin A eshte shpallur fitues ekipi i Terbunit, i cili siguron per here te pare kalimin ne Kategorine Superiore. Terbuni fitoi ndeshjen 2-0 perballë Beselidhjes. Ne grupin B eshte

shpallur fitues ekipi i Bylis, i cili ka mundur Lushnjen ne fushen e saj me rezultatin 0-1. Ekipi myzeqar 90 minuta perpara ndeshjes ishte ne krye dhe me humbjen e pesuar i humbi mundesite per tu ngjitur ne Kategorine Superiore. Ekipi ballshiot rikthehet ne Kategorine Superiore pas 1 viti mungese. Finalja per fituesin e Kampionatit te Kategorise se Pare do te zhvillohet ne daten 23 Maj 2015 ora 17:00.



Korabi ngjitet ne Kategorine e Pare

Korabi eshte shpallur fitues per Kategorine e Dyte Grupi A. Diten e diele kane luajtur ndeshjen e fundit ne qytetin e Shijakut dhe jane mundur me rezultatin 3-0 nga vendasit e Erzenit. Korabi si vendi i pare ne renditje ka fituar mundesine per tu ngjitur ne Kategorine e Pare. Kupa per fituesin eshte dhene nga anetari i Komitetit Ekzekutiv te FSHE, Vasil Bici. Finalja per titullin kampion te Kategorise se Dyte do te luhet midis Gramshit dhe Korabit.



Perfundon kursi "UEFA PRO 3"

Ne kompleksin kombetar te Kamzes, jane diplomuar 18 kursantet e "UEFA PRO 3". I pranishem ne ndarjen e diplomave ishte Sekretari i Pergjithshem i FSHE, Ilir Shulku. Me kete diplome, trajneret e licensuar kane te drejte te punojne ne te gjitha klubet e Evropes.

Arbitrat e linjës, e reja e gjykimit profesionist



Plarent Kotherja

Tani ata nuk janë më tre, siç jemi mësuar ti shohim në versionin klasik të futbollit por gjashtë. Që nga momenti kur në gjykimin e një ndeshjeje futbollit u njoh pozicioni jashtë loje dhe më pas kur u vendosën gjyqtarët anësorë, versioni klasik i drejtimit të një ndeshjeje futbollit ishte me tre gjyqtarë, ndryshimet kanë qenë të shumta. Mbas viteve 1990 kësaj tresheje ju shtua edhe një arbitri i katërt, i cili ishte një gjyqtar kryesor, që krahas gatishmërisë për të zëvendësuar ndonjë arbitër që eventualisht mund të dëmtohej, kishte për detyrë, të kryente ndërrimet (gjë që deri në atë

është edhe aplikimi i eksperimentit me gjashtë gjyqtarë ku katërshes klasike, i janë shtuar edhe arbitrat e linjës. Një eksperiment, i cili tashmë po aplikohet si në Europa League, Champions League dhe në vitin 2016 do të aplikohet edhe Kampionatin European. Gjithashtu ai është aplikuar edhe në më shumë se gjysmën e kampionateve kombëtare të vendeve të UEFA-s.

Historia e aplikimit të këtij eksperimenti

Për herë të parë ai është aplikuar në vitin 2007, në Kampionati European



kohë e kryente asistenti i parë) dhe kontrollonte pankinat e dy skuadrave respektive. Sot evoluimi i lojës dhe në mënyrë të veçantë, rritja e shpejtësisë në veprime, e ka bërë të detyrueshme edhe rritjen dhe përsosjen e nivelit të gjykimit. Një nga masat që UEFA, ka marrë për t'ju përgjigjur sa më mirë

U-19, të zhvilluar në Slloveni. Ndër arbitrat kryesorë, që për herë të parë drejtuan në mënyrë eksperimentale një gjashtëshe gjyqtarësh (Kryesori + Dy anësorët + Gjyqtari i katërt + gjyqtarët e linjës), ka qenë italianin i njohur Rizzoli. Në këtë eksperiment të parë, arbitrat e linjës qëndronin në krahun e kundërt



të anësorit ose në krahin e majtë të linjës së portës.

Përshtypjet e para ishin shumë pozitive, mbasi tashmë në kontrollin e zonës së rreptësisë, nuk ishin vetëm një palë sy por dy të tillë, të cilët kontrollin nga afër gjithçka. Duhet thënë që në fillim, se rëndësia e këtij eksperimenti, nuk ishte vetëm përcaktimi i golave të ashtuquajtur “fantazëm” por shumë e rëndësishme, ishte edhe kontrolli i rreptë në zonën e rreptësisë për faullat e ndryshëm të tipit shtyrje-mbajtje por edhe për ato vendime që kanë të bëjnë me pozicionin brenda apo jashtë vijave perimetrale, të zonës së rreptësisë.

Ana tjetër pozitive e eksperimentimit, ishte fakti, që me këtë mënyrë gjykimi asistenti mbetet i fokusuar vetëm tek pozicioni jashtë loje dhe jo si parë, kur ishte i detyruar që të ndihmonte kryesorin sa u takonte faullave, brenda zonës së rreptësisë. Kjo sollti një rritje rreth 20-30 % të të rendimentit të asistentit, në përcaktimin e pozicioneve jashtë loje. Dhe ky sigurisht, që ishte një përmirësim i ndjeshëm në këtë drejtim.

Një anë negative që u vu re pas eksperimentit, ishte pozicionimi

i keq i arbitrit, mbasi siç dihet ata mbështeten në një sistem diagonal, gjë që sillte përplasje me gjyqtarin e linjës. Dhe duke devijuar lëvizjet e tij shpeshherë ai ndodhej me kurriz nga asistenti. Kjo gjë u korrigjua brenda vitit, duke vendosur që albitri i linjës, të qëndronte në krahun e djathtë të portës ose pranë asistentit. Në këtë mënyrë, arbitri vazhdon lëvizjen e

tij diagonal dhe zona ndahet në dy pjesë sipas këndvështrimeve të sejcilit (arbitër dhe arbitër i linjës) dhe në këtë mënyrë përcaktimi i faullave, arriti në një rendiment deri në 90%, në aktivitetet e aplikuara. Pra ky eksperiment që filloi nga turneu U-19 në Slloveni, një vit më pas pasoi në fazën në grupe të Europa Ligës dhe më tutje u aplikua edhe Champions League.

Aplikimi i sistemeve nga UEFA, FIFA dhe Federatat

Tashmë është vendosur që edhe Kampionati European të jetë me gjashtë gjyqtarë. Duhet theksuar se FIFA mban një linjë tjetër, atë të sistemit elektronik të kontrollit të portës, të aplikuar së fundmi në finalen e Kampionatit Botëror Brazil 2014. Për hir të së vërtetës, ky system e ka precizionin më të lartë se sa syri human por ndërkohë kontrolli total që i bëhet lojës, nga asistenti me 6 arbitra për mendimin tim dhe të shumë specialistëve të tjerë, është më efikas se sa sistemi elektronik. UEFA ka ndërhyrë edhe në një detaj tjetër të vogël, nëse arbitri i katërt, ka qenë gjithmonë një arbitër me këtë funksion, tashmë është vendosur që ai të jetë asistent-arbitër dhe kjo për këtë



Tashmë është vendosur që edhe Kampionati European të jetë me gjashtë gjyqtarë. Duhet theksuar se FIFA mban një linjë tjetër, atë të sistemit elektronik të kontrollit të portës, të aplikuar së fundmi në finalen e Kampionatit Botëror Brazil 2014

arsye: Nëse dëmtohet arbitri kryesor, atë e zëvendëson arbitri i linjës dhe nëse dëmtohet njeri nga asistentët arbitrat, ai zëvendësohet nga arbitri i katërt. Një ndër Federatat e para që ka aplikuar këtë sistem me 6 arbitra, ka qenë Federata Italiane e Lojës së Futbollit (FIGC). Ndërkohë që tashmë janë më shumë se gjysma e Federatave Europiane që kanë aplikuar. Duhet theksuar se rezultati i këtij ndryshimi nga ana e UEFA-s, që tashmë nuk është një eksperiment (aplikohet në

Federata Shqiptare e Futbollit, ka aplikuar pranë UEFA-s në lidhje me këtë sistem.

Nga mendimi europian bën përjashtim Federata Angleze, e cila ka aplikuar një metotë krejtësisht të veçantë të kontrollit elektronik, që është i ndryshëm edhe nga sistemi që përdor FIFA. Me vendosjen e një sistemi kamerash pranë portave, në rast goli, arbitri

sinjalizohet nga një aparat si një orë, të cilën e mban në dorë. Ajo e njofton me kollonë zanore dhe me të shkruar, në rast se goli është i rregullt.

Një vit që sistemi përdoret edhe në Shqipëri

Në Shqipëri, ky sistem ka nisur të përdoret për herë të parë në finale e Superkupës së Shqipërisë, në gusht të vitit 2014 dhe më pas me fillimin e edicionit të ri futbollistik, në

ndeshjen kryesore të javës (në raste të veçanta edhe në dy ndeshjet kryesore) është vendosur që ndeshja të drejtohej me gjashtë arbitra. Për këtë arsye arbitrat janë pajisur me dy sisteme komunikimi, me komplet flamurësh me bipper dhe shkopat për dy gjyqtarët e linjës dhe asistentin e katërt. Çdo sistem ka nga një valë të caktuar, në mënyrë që të gjithë të komunikojnë me njeri tjetrin.

Në përfundim të vitit të parë të këtij ekperimentimi, ne i shikojmë arritjet si mjaft pozitive dhe premtuese. Në disa raste, vendimet e gjyqtarëve të linjës kanë qenë determinante, si në rastet e 11 metërshave ashtu edhe në ato gol, jo gol, ku për hir të sa vërtetës nuk kemi patur asnjë rast për tu kontestuar.



Kampionatet Kombëtare të disa shteteve të Europës), ka sjellë një rritje të nivelit të gjykimit. UEFA, për këtë arsye ka aplikuar prej dy vjetësh një ndihmë financiare, ku përfshihen përballimi i shpenzimeve për tre vjetët e parë të gjashtë arbitrave për një ndeshje, për ato Federata që dëshirojnë të aplikojnë këtë sistem.



Në ndeshjen kryesore të javës (në raste të veçanta edhe në dy ndeshjet kryesore) është vendosur që ndeshja të drejtohej me gjashtë arbitra

Interesant është fakti që eksperimente të tilla pozitive, që UEFA i aplikon, më pas shndërrohen në ligje për lojën e futbollit dhe automatikisht, nisin dhe bëhen zyrtare e të detyrueshme për Federatat anëtare. Kështu ka ndodhur me flamurët me bipper, më pas me sistemin e komunikimit dhe tashmë gjyqtarët e linjës. Për këtë arsye edhe

Të veçanta për arbitrat e linjës:

arbitrit.

Emërimi dhe zëvendësimi

Arbitrat e linjës mund të emërohen sipas rregullave të garës.

Ata duhet të jenë arbitra aktivë të një kategorie më të lartë të mundshme.

Në rast se një ndeshje zhvillohet me praninë e arbitrave të linjës, atëherë arbitri i katërt do të jetë një asistent i kategorive të larta.

Rregullat e garës duhet të deklarohen procedurën që duhet të ndiqet kur një arbiter(asistent) nuk është në gjendje të vazhdojë më lojën, dhe në këto raste veprohet si me poshtë:

a. Nëse një asistent dëmtohet, atëherë ai zëvendësohet nga arbitri i katërt.

b. Nëse arbitri kryesor dëmtohet, atëherë arbitri i linjës më me eksperiencë merr përsipër rolin e arbitrit, dhe ky i fundit në se ka mundësi merr përsipër rolin e arbitrit të linjës.

Detyrat

Kur në një ndeshje emërohen arbitrat e linjës, detyrat e tyre janë si më poshtë:

Të sinjalizojë kur gjithë perimetri topit kalon fushën e lojës apo vijën e portës.

Të përcaktojë kur skuadra ka të drejtë, të perfitojë një goditje nga këndi apo është rivënie e topit në lojë nga porta.

Të sinjalizojë kur kemi sjellje të pahijshme apo ndodh ndonjë incident tjetër, që është jashtë shikimit të

Kur kemi një veprim sulmues, sidomos kundërsulmi, pamja e arbitrit është më e mirë



se e arbitrit, veçanërisht në zonën e penalltisë, atëherë ai duhet të sinjalizojë për çdo parregullsi.

Në rastin e goditjes së një penalltie, është detyrë e tij të sinjalizojë për lëvizjen e portierit, si dhe të përcaktojë nëse topi kalon vijën e portës.

Gjatë ekzekutimit të penalltisë arbitri I vijës, qëndron në vijën fundore, ndërsa asistenti në vijë të drejtë me lojtarin e parafundit.

Ndihma

Arbitri i linjës, gjithashtu ndihmon arbitrin të kontrollojë ndeshjen në përputhje me rregulloren e lojës por vendimin përfundimtar(final) gjithmonë duhet të merret nga arbitri.

Në rast të ndërhyrjeve të panevojshme ose sjelljeve të pahijshme, arbitri duhet të largojë atë nga detyrat e tij, dhe me pas bën një raport të hollësishëm organeve kompetente.



Ata duhet të jenë arbitra aktivë të një kategorie më të lartë të mundshme. Në rast se një ndeshje zhvillohet me praninë e arbitrave të linjës, atëherë arbitri i katërt do të jetë një asistent i kategorive të larta

Historia e “penalty kick”



Uvil Zajmi



Nëse ndonjë lojtar tenton qëllimisht të pengojë apo të mbajë një lojtar kundërshtar, ose të mbajë topin brenda dymbëdhjetë metrave nga vija e portës të zonës së tij, arbitri gjykatës do ti japë palës kundërshtare një penallti, që do të jetë një goditet e lirë nga cdo pikë 12 yards (10.89m) nga vija e portës

Ideuesi, një ish-portjer

Idea e dhënies së një penalltie ka si ideator, portjerin irlandezo-verior Eilliam McCrum. Djalë i një ndërtuesi Robert Garmany McCrum, pasi ka përfunduar studimet në “Royal Schol” dhe pastaj në “Trinity College” në Dublin, Eilliam. Për shumë vite ka luajtur si portjer i “Milford Everton FC” dhe në sezonin 1890-91, pas 14 takimesh Milford renditet në fund të klasifikimit, pa asnjë pikë, duke rënë një kategori me poshtë, me dhjetë gola të shënuar e 62 të pësuar. Gjithashtu I ka qenë edhe një shahist I mirë me “Armagh” duke marrë pjesë në turne individuale të kohës. Ai ka qenë një Ambasador i Paqes dhe përfaqësues në mjaft aktivitete sportive si anëtar i “Milford Football Club” dhe “Armagh Cricket Club’s e Armagh Rugby football Club”. Vdiq pas një sëmundje të gjatë në dhjetorin e vitit 1932.

Klubi Milford FC. William McCrum, i dyti majtas në rreshtin e mesit



Viti zyrtar i njohjes

Data nuk përputhet ose ka diferencë që lëvizin nga vitit 1885-1890. Mc Rum ishte anëtar i Federatës së Futbollit të Irlandës, kur propozoi për

akordimin e penalltisë. Sipas tij, nisur nga qëllimi të frenojë e të ndëshkojë agresivitetin e lojtarëve të skuadrës së tij që përplaseshin e kërkonin me dhunë të ndalonin ata kundështraë që vinin drejt portës së tij, sipa sidesë së tij, loja duhet të ndalohet dhe të jepet një goditje e lirë për ekipin kundërshtar. Idea iu dorëzua në qershor të 1890 Jack Reid, njëkohësisht Sekretar i Federatës Irlandeze të Futbollit por edhe përfaqësues i IFAB gjatë një mbledhje të saj. Në propozimin original lexohet:

“If any player shall intentionally trip or hold an opposing player, or deliberately handle the ball within twelve yards from his own goal line, the referee shall, on appeal, award the opposing side a penalty kick, to be taken from any point 12 yards from the goal line, under the following conditions: All players, with the exception of the player taking the penalty kick and the goalkeeper, shall stand behind the ball and at least six yards from it; the ball shall be in play when the kick is taken. A goal may be scored from a penalty kick” (“Nëse ndonjë lojtar tenton qëllimisht të pengojë apo të mbajë një lojtar kundërshtar, ose të mbajë topin brenda dymbëdhjetë metrave nga vija e portës të zonës së tij, arbitri gjykatës do ti japë palës kundërshtare një penallti, që do të jetë një goditet e lirë nga cdo pikë 12 yards (10.89m) nga vija e portës, sipas kushteve të mëposhtme: të gjithë lojtarët, me përjashtim të lojtarit që godet penalltinë dhe portieri, do të qëndrojnë prapa topit të paktën gjashtë yards nga ato; topi do të jetë në lojë, kur është kryer goditja. Një gol mund të shënohet nga një goditje e penalltisë). Fillimisht propozimi gjeneroi shumë diskutime dhe indinjatë midis lojtarëve dhe shtypit si një “lëvizje irlandeze”, si “dënimi me vdekje”. Opinini publik

ndryshoi mendim pas një takimi në FA Cup, midis Stoke City e Notts Country me 14 shkurt 1891, kur u aplikua një goditje e tillë. Aprovimi zyrtar u morr pikërisht me 2 qershor 1891, në "Aleksandra Hotel", Bath. St. në Gllazgou, një vit pasi ishte propozuar, pas të cilës, u vendos që Kapitulli I Penalltisë të ketë numrin 13-të të

Jugosllavinë, falë monellës së hedhur nga arbitri në përfundim të sfidës me Rusinë që u mbyll në barazim.

Ish-arbitri Karl Ĕald, ideuesi i gjujtjeve të penalltive.

Sërish një arbitër është ideuesi i serive kualifikuese të pesë penalltive.

Propozimi është bërë nga ish-arbitrit gjerman Karl Wald në vitin 1970. Federata bavareze kërkoi ta bllokonte propozimin, por mbeti e vetme kur asambleja e maxhorancës, vendosi në favor të aplikimit, që pasoi pak më vonë edhe nga Feretata e Futbollit Gjerman, FIFA e UEFA, e e cila mbështetën propozimin. Por, sipas të tjerëve, ideatori i kësaj metode të re, mund të jetë edhe izraeliani Yosef Dagan, pasi skuadra kombëtare e Izraelit u eliminua nga gjysëmfinalët e Olimpiadës 1968, pas hedhjes së shortit. Sidoqoftë variantet dhe ideatorët, goditjet e penalltive kualifikuese I gjejmë në vitet 50-të në disa turne jo zyrtare



Rregullores së Lojës. Penalltia e parë është ekzekutuar gjatë një takimi në një fushë futbollit të Milford, Armagh, 70 km në perëndim të Belfastit. Dhënia e një "penalty kick", ka marrë edhe cmimin Nobel për letërsinë, kur shkrimtari Camilo Jose Cela, publikoi librin "Goditja vdekjeprurëse në futbollit"

Historia, e penalltive kualifikuese

Në të kaluarën për të përcaktuar fituesin e një ndeshjeje të mbyllur në barazim në aktivitetet e organizuar nga FIFA e UEFA, bëhej me short, si në rastin e fazës finale të "Euro 68", kur Italia kualifikohet për në finale me

europiane dhe latine me fëmijë, ku lojtarët nuk alturnoheshin dhe një futbollist godiste njëra pas tjetrës të pesë penalltitë dhe fituese u shpallte skuadra që kishte shënuar më shumë. Në rast barazimi pas 10 goditjeve, skuadrat rifillonin nga e para, me të njëjtin futbollist). Zyrtarisht goditjet e 5 penalltive në kompeticionet europiane janë aplikura fillimisht në Kupën e Kampioneve në sezonin 1970-71, ku lojtarët detyrimisht alturnoheshin, ndërsa turneu i parë ndërkombëtar që u ekzekutuan goditjet e 5 penalltive ishte "Euro 1976". Në këtë eveniment, pas barazimit 2-2 edhe pas kohës shtesë 2x15, midis Cekoslovakisë dhe RF Gjermane, penalltia decisive u



Penalltia e parë është ekzekutuar gjatë një takimi në një fushë futbollit të Milford, Armagh, 70 km në perëndim të Belfastit. Dhënia e një "penalty kick", ka marrë edhe cmimin Nobel për letërsinë, kur shkrimtari Camilo Jose Cela, publikoi librin "Goditja vdekjeprurëse në futbollit"



albpetrol
shoqëria shqiptare e naftës



Krenarë që mbështesim
Ekipin Kombëtar të futbollit

ekzekutua në formë luge nga Antonio Panienka, pasi Uli Hënës kishte gjuajtur jashtë atë paraardhëse.

Edhe në sporte të tjera

Gjuajtjet kualifikuese të penalltive, apo aplikimi i tyre në një garë sportive e gjejmë edhe në sporte të tjera si bandy, futboll në sallë, ndeshje me kanoa, futboll galeik, floorball, hokei in-line, hokei në akull, hokei në bar, hokei në pistë, hurling, hendboll, vaterpol dhe polo.

Kuriozitete

- Një grup kërkuesish anglezë ka mundur të gjejnë formulën për një “penallti perfekte”, që siguron realizimin 100%, duke llogaritur shpejtësinë, hapat që duhen bërë dhe këndin e goditjes.
- Futbollisti i njohur hollandez i “Ajaksit” Johan Krojff, në ndeshjen kundër Helmond Sport me 5 dhjetor 1982, ka bërë një interpretim që njihet në histori si “penalltia me dy takime”: Ndërsa pritej të godiste direkt në portë, Krojff e shtyu topin përpara drejt portës, duke I dhënë mundesi Jepsen Olsen, i cili ja ktheu sërish Krojffit që shënoi. Një rast analog u tentua të përsëritej edhe nga Robert Pires e Thierry Hanry në takimin Arsenal-M. City të 22 tetorit 2005. Bëhet fjalë për një nga pikat e rregullores, tek Kapitulli i “Penalltisë”, sipas të cilës nuk është detyrimisht të shënosh drejtpërsëdrejti nga pika e bardhë, por mjafton që topi të lëvizë ose të shtyhet

detyrimisht përpara ose anash.

- Futbollisti argjentinas Martino Palermo mban rekordin negativ për penalltitë e humbura në një ndeshje të vetme: Tre. Rekordi u vendos në vitin 1999 në një ndeshje Argjentinë-Kolumbi për Kupën e Amerikës.
- Më 23 janar 2005 është vendosur rekordi i gjuajtjeve të penalltive në një ndeshje: 48, midis KK Palace e Civics, një takim për Kupën e Namibisë. Të fituar dolën KK Palace, 17-16.
- Dy finale botërore, një i vajzave dhe i meshkujve, fituesit janë vendosur nga pika e bardhë. Për herë të parë në “Usa 94”, midis Brazilit dhe Italisë 0-0, nga goditjet e penalltive fitoi Brazili 4-3, duke marrë edhe kupën. Për italianët, gabuan Baxhio e Barezi.

Historia e penalltive në Shqipëri

Ato kualifikuese në Shqipëri janë aplikuar në fillim të viteve 60-të, kur në asnjë vend tjetër të Europës apo Botës nuk ndiqej një praktikë e tillë, madje FIFA e UEFA i kanë përdorur shumë vite më vonë (1976). Duhet të ketë qenë një propozim i Anton Mazrekut, drejtues në FSHF, publicist i njohur, që ka dhënë idenë për ti aplikuar në aktivitetet kombëtare zyrtare.

Kupa e Republikës, Kavajë, “Besa-17 Nëndori”

7 prill 1963. Ndeshja e parë e luajtur në “Qemal Stafa” ka përfunduar 3-2 për Besën,

ndërsa e kthimit në fushën e vjetër, 1-0 për “17 Nëndorin”. Sipas rregullores së aktivitetit, edhe pas kohë shtesë 2x15 minuta dhënë nga arbitri Gruda, fituesi do të shpallet nga goditjet e pesë penalltive, një praktikë e pa njohur për kohën. Është ndeshja në të cilën Ali Mema, mesfushori I 17 Nëndorit, por në rolin e portjerit I vendosur në portë nga trajneri Alla, (pasi ishin të dëmtuar dy portjerët gjatë lojës), ka pritur 3 penalltitë të gjuajtura nga Rexha I Besës, ndërkohë që Bukoviku i ka ekzekutuar me sukses duke shënuar rradhazi në portën e Shefqet Topit. Ky është edhe rasti i parë, i aplikimit të pesë penalltive në një aktivitet zyrtar në Shqipëri, dhe fitues u shpall 17 Nëndori me shifrat 5-3, ku sic shohim nuk ka alternim por vetëm një lojtar është ekzekutues i tyre.

Rragami, 7 penallti rradhazi

1 maj 1972. Sërish në finale të Kupës së Republikës, në Shkodër luhet, Vllaznia-Besa. 2-0 për kavajasit sfida e parë dhe 2-0 për shkodranët e dyta me gola realizuar nga Ramazan Rragami me dy penallti dhënë në sejcilën pjesë nga arbitri Ramiz Pregja. Pas kohë shtesë dhe kur shifrat nuk ndryshojnë, ka startuar seria e 5 goditjet të 11-te metrave. Vazhdon rregulli që vetëm një lojtar mund të gjuajë të pestë penalltitë dhe Ramazan Rragami nuk ka gabuar asnjë prej tyre duke i realizuar të gjitha në portën Arkaxhiut, pra gjithsej 7 në një takim të vetëm duke përfshirë edhe ato të lojës, një rast unikal i papërsëritshëm. Për kavajasit ka humbur Merhori, kur topi u përplas në shtyllën e portës të mbrojtur nga Ndoja. Kupën e merr Vllaznia, duke fituar nga pika e bardhë 5-3.

Me Gjermaninë, një përballje pa limite



Nga ndeshja e parë në Dortmund, deri tek miqësorja e luksit, e zhvilluar në “Arena” të Elbasanit, midis veteranëve. Cilat kanë qenë sfidat legjendare Shqipëri -Gjermani? Nga nga barazimi i paharruar 0-0, tek goli i Gerd Mylerit në Tiranë, ai i Tomorrit e Josës në Gjermani. Ndishjet, protagonistët, një histori gjysëm shekullore që nuk njeh limite.

Sfidat me Germaninë Lindore

Takimet me futbollin e madh gjerman janë të ndara në dy përballje, pasi kemi luajtur me dy Gjermani: Atë Lindore por edhe me Gjermaninë Perendimore. Madje përballja e parë historike i takon 1 majit 1958, në Tiranë kur në një ndeshje miqësore, Shqipëria do të barazojë 1-1 me RD Gjermane. Goli i parë i kombëtares shqiptare të drejtuar nga Loro Boroçi ka për autor Koleç Krajën, në minutat fillestare, ndërsa gjermanët kanë barazuar në fund me anë Troager. Në këtë formacion gjejmë emra të njohur, si Maliqati, Fagu, Ndini, Deliadhisi, Kraja, Jareci, Resmja, Deda, Merja, etj. Me RD Gjermane, do të ndeshemi edhe dy

herë të tjera, në fillim të viteve 70-të, për kualifikueset e botërorit 1974. Me 8 prill, në Magdeburg, Shqipëria që drejtohet nga Myslym Alla humbet 2-0, me gola të gjermanëve të njohur për kohën Streich e Shparvaser,(62',69'). Pas një viti, në “Qemal Stafa”, një Shqipëri që ka Ilia Shuken, trajner pëson një humbje shokuese 1-4 (gol i Mihal Gjilkës). Në përbërje janë futbollistë si Rama, Muhedini, M. Gjika, Berisha, M. Vaso, Sejdini, G. Xhafa, Ibërshimi, R. Rragami, M. Gurma, Përnaska, Pano, U. Xhafa, Braho, Çurri, Hoxha. Këtu vjen edhe vetëpezullimi 3 vjeçar, ndërsa me këtë kombëtare nuk do të takohemi asnjëherë më.

Përballjet me klube

Me ekipet gjermane, ka startuar edhe

pjesmarrja e skuadrave shqiptare në evenimentet europian me klube. Pikërisht, me Këlnin, është një ndër sfidat historike, kur Partizani kampion u ndesh në turin e parë të Kupës së Kampioneve më vitin 1964. Barazim 0-0 në Qemal Stafa dhe 2-0 për Këlnin, në atë të kthimit. Pas turneve të Hanoit dhe Lajpcigut, në të cilat kemi ndeshje të skuadrës së

Ajo që nuk harrohet

Sigurisht që është ndeshje më e madhe, më e famshme dhe e paharruara për shqiptarët në përballjet me RF Gjerme por edhe më tej. Historike e papërsëritshme. 17 dhjetor 1967. Në Qemal Stafa”, në një ditë me shi, në



Partizanit me ato gjermane, duhet të kalojnë vite e dekada që shorti të sjellë në Tiranë, “Bayern” të Mynihut. Sërish për Kupën e Kampioneve, regjistrohen dy përballje historike: Bayern - 17 Nëntori 3-1 në Mynih, me gol të Arben Migës dhe 0-3 në Tiranë.

Në Dortmund, sfida e parë zyrtare

Me përfaqëuesen e RFGjermane, kombëtarja shqiptare është ndeshur më shumë se me çdo përfaqësuese tjetër, plot 14 herë. Vetëm një barazim, që mbart një histori unike për futbollin shqiptar por edhe atë gjerman. Pastaj rivalitet, sfida dramatike por asnjëherë fitues. E para zyrtare me RFGjermane nënkampione e botës, daton në 8 prillin e 67-tës, në Dortmund, për Eliminatorët e Kampionatit Europian “Italia 68”, Shqipëri-RFGjermane 6-0 dhe G. Myler është autor i 4 golave. Në kombëtaren e Borçit aktivizohen, Janku, Frashëri, A. Mema, Vaso, Rragami, Kazanaxhi, Xhaka, Hyka, Pano, Bizi, Ishka.

një stadium tejet të mbushur në të parën sfidë në Tiranë, Shqipëri-RFGjermane 0-0. Rezultat surprizë, që eliminon Gjermaninë nga faza finale e Europianit. Madje edhe mund të kishin humbur, kur arbitri austriak Marshall nuk vlerëson gol të rregullt, një gjutajtje të Gjinalit. Por cilët ishin ata që tronditën futbollin gjerman? Dinella, Gjinali, Jorgaqi, Vaso, Rragami, Shllaku, Pano, A. Mema, Kazanaxhi, Bizi. Tr. L. Borici.

Goditja e magjike e Mylerit

I tillë ka qenë dhe mbetet. Një gol i shënuar në minutën e 38-të nga Gerd Myler, shpëtoi Gjermaninë nga një tjetër rezultat surprizë. Përsëri në Qemal Stafa”, Gjermania e shkurtit të vitit 1971 ka ardhur e përforcuar. Nuk dëshiron të gabojë, duke sjellë në Tiranë formacionin më të madh të historisë së saj: Majer, Vogts, Packe, Bekenbauer, Shnelinger, Veber, Grabovski, Netzer, G. Muller, Overath e Heinkes. Tr. H. Shën. Decizive ka qenë minuta e 38-të, kur për një pakujdesi



Historike e papërsëritshme. 17 dhjetor 1967. Në Qemal Stafa”, në një ditë me shi, në një stadium tejet të mbushur në të parën sfidë në Tiranë, Shqipëri-RFGjermane 0-0. Rezultat surprizë, që eliminon Gjermaninë nga faza finale e Europianit

të mbrojtjes shqiptare, Muller ka realizuar atë gol në porten nga qyteti. Pastaj, ndeshja e kthimit në Karsruhe, në mujain qershor: Humbasim 2-0, shënojnë Netzer e Grabovski. Këtu do të ndahemi, përkohësisht me kombëtaren e RFGj-së, për tu takuar

dhe tifozët në Ludvikpark stadion dhe një fund 2-1 por me drithërima për skuadrën e Jup Dervalit.

Goli historik i Josës

Ai gol, ajo ndeshje është një tjetër faqe e historisë të takimeve Shqipëri-RF Gjermane. Ndonëse bilanci është totalisht në favor të tyre, dy janë momentet që i nderojnë shqiptarët, madje në të dyja rastet rezultojnë fatale për futbollin gjerman: Barazimi 0-0 në Shqipëri dhe ai në Trirer me 19 nëntor 1983, U21 RFGjermane-Shqipëri 1-1. Skuadra e drejtuar nga Rragami kalon në 8 finalistet e Europës, ndërsa goli shënuar nga Mirel Josa, mbart vlera të madha, si sportive ashtu edhe historike.



në sfidën e rrallës, me 1 prill 1981, në Tiranë për Eliminatoret e Kampionatit Botëror, të cilën udhëtuesit e fitojnë 2-0 me një dygolësh të Shusterit. Takimi vijues do të jetë një tjetër humbje shokuese, pas asaj 6-0 shumë vite me parë: me 18 tetor, po në Dortmund, 8-0. Një rezultat që nuk do koment. Për trajnerin L. Boriçi, kjo është ndeshja e fundit me kombëtaren, pasi vendin e tij do të caktohet Shyqyri Rreli.

Goditja fantastike e Rrakllit

Realisht është goli më i bukur, ai i shënuar nga Altin Rraklli në përballjet Shqipëri-RFGjermane. 19 dhjetor 1994, në Kaizeslautern, Gjermani – Shqipëri 2-1. Kanë realizuar fillimisht vendasit me Klinsman e Matheus, por do të vijë minuta e 57 që i ka habitur gjermanët kur kombëtarja e Bajkos, ka shkurtuar diferencën në 2-1, me një gol fantastic, të paparë të Altin Rrakllit i cili fluturimthi ka shënuar nga një pozicion pak diagonal, në kufijtë e zonë së 16 metarve. Një gol i jashtëzakonshëm, i vlerësuar si “Goli i Vitit”.

Sfida në Granada

Është e para dhe e vetmja përballje të që është lujatur në një fushë asnjëse, madje ka qenë e rivalizuar deri në fund, dhe takimi është mbyllur 3-2. Janë vitet e trazirave të 97-tës dhe UEFA ka vendosur që ndeshjet e kombëtares, Shqipëria ti zhvillojë jashtë territorit të saj, duke caktuar qytetin spanjoll Granada. Në



Saarbrucken, minuta e 22, Tomorri i gjendur në zone, ka devijuar në rrjetë e Shumakerit një harkim të ardhur nga e djathta

Kur Tomorri shtangu Ludvigparkstadionn

I ka takuar mesfushorit të Partizanit dhe të Kombëtares të realizojë golin e parë shqiptar në Gjermani. Madje surprizë, pasi i ka shokuar momentalisht ata. 20 nëntor 1983, në Saarbrucken, minuta e 22, Tomorri i gjendur në zone, ka devijuar në rrjetë e Shumakerit një harkim të ardhur nga e djathta. Por, vetëm 2 minuta ka zgjatur avantazhi, pasi Rumenige ka barazuar, ndërsa Strak në fund të ndeshjes, ka hequr ankthin e pafund që kishte përfshirë skuadrën



këtë përballje, skuadra e trajnerit Hafzi ka qenë e jashtëzakonshme: Humbasim por takimi ka shumë emicione, është i hapur deri në fund. Fitojmë gjermanët, shënohen pesë gola të cilat kanë vetëm dy autorë: Kirsten që shënoi tri herë dhe Bledar Kolën me një dygolësh.

Në Hanovër, shtatë gola

Eshta takimi me 7 gola shënuar nga të dyja skuadrat. 11 tetor 1997, në Hanover për Eliminatoret e Kampionatit Botëror. Gjermani-Shqipëri 4-3. Madje deri në minutën e 88-të pas golave të Tares e R. Vatës, rezultati ka qenë në barazim 3-3. Situatën tejet rrënjëthënë, e të tensionuar të skuadrës së Berti Vogts do ta shpëtojë vetëm goli i Bierhoff në minutën e 92-të. Është takimi kur edhe trasmetimi televiziv nën komentin e Grillos nga Hanoveri për defekt teknik u ndërpre pikërisht në minutat e fundit dhe shqiptarët e mendonin në barazim ndeshjen, pa u informuar për golin e gjermanëve.

Minuta fatale e Leverkusenit

24 Mars 2001. Leverkusen, minuta e 88-të, barazim 1-1. Desler ka shënuar pari por Bledar Kola ka ekuilibruar shifrat në 66-tën dhe kur kanë mbetur vetëm

pak minuta, vendasit në përpjekjet e fundit dhe me shpresa të humbura do ti ndihmojë minuta fatale, ajo e fundit e takimit që do të ndëshkojë shqiptarët. Nga një pozicion i dyshimtë, Klose ka realizuar në portën e Strakoshës, pas të cilës arbitri italian Cezari shumë i kritikuar, ka përfunduar lojën, me një pafundësi polemikash.

Viti 2001 dhe e fundit me “veteranët”

Dy janë sfidat zyrtare, të fundit që jemi ndeshur me RF Gjermane. I takojnë, shekullit të ri, kur në vitin 2001, luhen: Në Leverkusen 2-1 dhe në Tiranë 2-0. Për të ardhur në muajin maj, të 2015, në një takim unikal, të rrallë dhe tejet argëtues: Në “Elbasan Arena”, Over 35 Shqipëri-RG Gjermane 3-4 për veteranët gjermanë.

Golat e shqiptarëve

I pari në trasfertë, ka firmën e Genc Tomorrit, ndërsa ai në Shqipëri është realizuar nga një mbrojtës: Targaj në minutën e 81-të me 11m metërsh në takimin e 30 marsit, Shqipëri RFGJ 1-2. Në vijim po dy mbrojtës janë autorë të golave shqiptarë: Zmijani në atë goditje magjike në Qemal Stafa dhe Vata në Gjermani. Ndaj gjermanëve ka shënuar edhe Tare e Rraklli por Bledar



Sfida në Granada
Eshtë e para dhe e vetmja përballje të që është luajtur në një fushë asnjëse, madje ka qenë e rivalizuar deri në fund, dhe takimi është mbyllur 3-2

Kola qëndron i pari si goleador, me dy gola të realizuar ndaj tyre.

Golat e gjermanëve

Nga 5 gola kanë shënuar: G. Muller dhe Karl Hainz Rumenige. Katër ka realizuar Kirtsen, ndërsa nga dy gola kanë: Lohr, Shuster, Fisher, Klinsman,

Bierhoff. Por, ndaj shqiptarëve kanë realizuar edhe të famshmit: Netzer, Grabovski, Litbarski, Brajtner, Voller, Mateus, Klose dhe Balak.

Protagonistët e dy kombëtareve

Nga Helmut Shën, Derval, Vogts,

kanë shkelur në Qemal Stafa. Po kështu edhe për teknikët shqiptarë. Nga legjendari i stolit, Boriçi, Alla, Shuke, Rreli, Bajko, Hafizi, Zhëga. Po kështu edhe futbollistët: Nga Pano, tek Tare, nga Overat tek Bierhoff, dhe ndërmjet tyre një pafundësi me emra që nuk njohin limite. Të gjithë protagonistë të padiskutueshëm.

Statistikat me Gjermaninë

01.05.1958	Tiranë	Shqipëri – RD Gjermane	1-1	(Miqësore)
08.04.1967	Dortmund	RF Gjermane – Shqipëri	6-0	(Kualifikueset European)
17.12.1967	Tiranë	Shqipëri - RF Gjermane	0-0	(Kualifikueset European)
17.02.1971	Tiranë	Shqipëri - RF Gjermane	0-1	(Kualifikueset European)
12.06.1971	Karlsruhe	RF Gjermane – Shqipëri	2-0	(Kualifikueset European)
07.04.1973	Magdeburg	RD Gjermane – Shqipëri	2-0	(Kualifikueset Botëror)
03.11.1973	Tiranë	Shqipëri – RD Gjermane	1-4	(Kualifikueset Botëror)
01.04.1981	Tiranë	Shqipëri - RF Gjermane	2-0	(Kualifikueset Botëror)
18.11.1981	Dortmund	RF Gjermane – Shqipëri	8-0	(Kualifikueset Botëror)
30.03.1983	Tiranë	Shqipëria - RF Gjermane	1-2	(Kualifikueset European)
20.11.1983	Sarbrücken	RF Gjermane - Shqipëri	2-1	(Kualifikueset European)
16.11.1994	Tiranë	Shqipëri – Gjermani	1-2	(Kualifikueset European)
18.12.1994	K>lautern	Gjermani – Shqipëria	2-1	(Kualifikueset European)
02.04.1997	Granada	Shqipëri – Gjermani	2-3	(Kualifikueset European)
11.10.1997	Hannover	Gjermani - Shqipëri	4-3	(Kualifikueset Botëror)
24.03.2001	Leverkusen	Gjermani -Shqipëri	2-1	(Kualifikueset Botëror)
06.06.2001	Tiranë	Shqipëria - Gjermani	0-2	(Kualifikueset Botëror)

Totali:

Shqipëria	14	0	1	13	10 - 38	1
Gjermania	14	13	1	0	38 - 10	27
Shqipëria	3	0	1	2	2 - 7	1
Gjermania Lindore	3	2	1	0	7 - 2	5

Rezultati më i mirë:

Shqipëri - RD Gjermane	1-1
Shqipëri – RF Gjermane	0-0

Rezultati më i keq:

RF Gjermane – Shqipëri	8-0
------------------------	-----



DIGITALB

KUQEZIJATI